

# **MARRËVESHJA PËR TË DREJTËN E PATENTËS**

Miratuar në Gjenevë më 1 qershor të vitit 2000.

E shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 163/09

## SHPREHJE TË SHKURTUARA

### Neni 1

Në këtë marrëveshje, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe:

- (i) „Enti“ do të thotë trup i palës nënshkruese që është përgjegjës për njohjen e patentave apo për çështje të tjera lidhur me këtë marrëveshje;
- (ii) „Aplikim“ do të thotë aplikim për njohje të patentës, në përputhje me nenin 3;
- (iii) „Patentë“ do të thotë patentë, në përputhje me nenin 3;
- (iv) Çdo referencë për “person” interpretohet si referim që përfshin person fizik dhe person juridik;
- (v) „komunikimi“ do të thotë cilido aplikim apo cilado kërkesë, deklaratë, dokument, shkresë apo informacione të tjera që kanë të bëjnë me aplikimin apo patentën, pa marrë parasysh se a kanë të bëjnë apo jo me procedurën e kësaj marrëveshje, e që dorëzohen deri tek Enti;
- (vi) „Regjistrat e Entit“ do të thotë tërësi e informacioneve që i ruan Enti, e që kanë të bëjnë apo që përfshijnë aplikacionet e dorëzuara dhe patentat e fituara nga ai Ent apo trup tjetër përgjegjës i palës përkatëse nënshkruese, pa marrë parasysh mjetin në të cilin këto informacione ruhen;
- (vii) „regjistrim (evidentim) në regjistër“ do të thotë evidentimi (regjistrimi) i çdo informacione në regjistrat e Entit;
- (viii) „aplikuesi (dorëzuesi i aplikacionit) “ do të thotë personi që në përputhje me regjistrat e Entit, dhe në pajtueshmëri me ligjin e zbatueshëm, dorëzon aplikimin (fletëparaqitje) për patentë ose person që dorëzon aplikimin apo merr pjesë në dorëzimin e aplikimit;
- (ix) „bartës“ do të thotë personi që në përputhje me regjistrat e Entit është bartës i patentës;
- (x) „përfaqësues“ do të thotë përfaqësues sipas ligjit në zbatim;
- (xi) „nënshkrim“ do të thotë çdo mënyrë e vetidentifikimit;
- (xii) „gjuhë e pranuar nga Enti“ do të thotë çdo gjuhë e pranuar nga Enti për procedurën adekuate para Entit;
- (xiii) „përkthim“ do të thotë përkthim gjuhësor ose, kur është adekuate, transkriptim me alfabet apo tërësi shenjash të pranuar nga Enti;
- (xiv) „procedura para Entit“ do të thotë çdo procedurë që udhëhiqet para Entit në lidhje me aplikimin ose patentën;
- (xv) përveç nëse në një kontekst tjetër nënkuptohet ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë edhe ato në shumës dhe e kundërta, si dhe përemrat personal nga gjinia mashkullore përfshijnë edhe ato të gjinisë femërore;
- (xvi) „Konventa e Parisit“ do të thotë Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, e nënshkruar më 20 mars të vitit 1883, e rishikuar dhe ndryshuar;
- (xvii) „Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e patentave“ do të thotë Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e patentave, të nënshkruar më 19 qershor të vitit 1970, bashkë me Rregulloren dhe Udhëzimet administrative në përputhje me këtë marrëveshje, të rishikuara, ndryshuara dhe plotësuara;
- (xviii) „pala nënshkruese“ do të thotë çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare që është palë në këtë marrëveshje;

- (xix) „ligji i aplikueshëm (ligji që zbatohet)” do të thotë, kur pala nënshkruese është shtet, ligji i atij shteti, ndërsa kur pala nënshkruese është organizatë ndërqeveritare, dispozitat ligjore sipas të cilave vepron (funksionon) organizata ndërqeveritare ;
- (xx) „dokumenti për ratifikim“ interpretohet sikur përfshin dokumente për pranim apo miratim;
- (xxi) „Organizata“ do të thotë Organizata Botërore për Pronësi Industriale;
- (xxii) „Byroja ndërkombëtare” do të thotë Byroja ndërkombëtare e Organizatës;
- (xxiii) „Drejtori gjeneral“ do të thotë drejtori gjeneral i Organizatës

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 2

(1) [*Kushte më të favorshme*] Pala nënshkruese mund të parashohë kushte të cilat, nga këndvështrimi i aplikuesëve dhe bartësve, janë më të favorshme nga kushtet e kësaj marrëveshje dhe Rregullore, përveç kushteve nga neni 5.

(2) [*Mosrregullimi i së drejtës materiale për patenta*] Asgjë në këtë Marrëveshje apo në Rregullore nuk ka për qëllim të interpretohet si rregull që do të kufizonte lirinë e palës nënshkruese të përcaktojë kushte të tilla ashtu siç dëshiron nga e drejta materiale që zbatohet lidhur me patentat.

### Aplikime dhe patenta mbi të cilat zbatohet Marrëveshja

### Neni 3

(1) [*Aplikime*]

(a) Dispozitat nga kjo marrëveshje dhe Rregullorja zbatohen në aplikimet nacionale dhe regjionale për patenta për shpikje (zbulime) dhe për aplikime të ndara për patenta që dorëzohen në Entin e palës nënshkruese. Këto janë:

(i) lloje të aplikimeve që mund të dorëzohen si aplikime ndërkombëtare në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave;

(ii) aplikime të ndara nga llojet e aplikimeve sipas pikës (i), për patenta për zbulime ose për patenta shtesë, në përputhje me nenin 4d paragrafi (1) apo paragrafi (2) nga Konventa e Parisit.

(b) Në bazë të dispozitave të Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave dispozitave të kësaj Marrëveshje dhe Rregullores, zbatohen për aplikimet ndërkombëtare për patenta për zbulime dhe për aplikime të ndara për patenta, të dorëzuara në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave:

(i) në raport me kufizimet kohore që zbatohen sipas neneve 22 dhe 39 paragrafi (1) nga Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e patentave në Entin e palës nënshkruese;

(ii) në raport me cilëndo procedurë të filluar në atë datë apo pas asaj date në të cilën aplikimi merret në procedurë apo shqyrtimi i aplikimi ndërkombëtar mund të filloj, në pajtim me nenin 23 apo nenin 40 të kësaj Marrëveshje.

(2) [Patentat] Dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe Rregullorja zbatohen në patentat nacionale dhe regjionale për zbulime, dhe në ato nacionale dhe regjionale për aplikime të ndara për patenta, të cilat njihen si të vlefshme për palën nënshkruese.

#### Përfundim për shkaqe sigurie

##### Neni 4

Asgjë në këtë marrëveshje dhe në Rregullore nuk do të kufizojë lirinë e palës nënshkruese për të ndërmarrë veprime nëse konsideron se është e domosdoshme për ruajtjen e interesave bazë të sigurisë.

#### Data e aplikimit (dorëzimit)

##### Neni 5

#### (1) [Elementët e aplikimit]

(a) Përveç nëse është përshkruar ndryshe në Rregullore, dhe është subjekt i paragrafëve nga (2) deri (8), pala nënshkruese do të parashohë që data e dorëzimit të aplikimit të jetë dita në të cilën Enti i saj, në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër të paraparë nga ana e Entit, sipas zgjedhjes së aplikuesit, të ketë pranuar elementët në vijim:

- (i) tregues që qartë dhe të kuptueshëm se elementët konsiderohen për aplikim;
- (ii) të dhënat mundësojnë që identiteti i aplikuesit të përcaktohet apo lejojnë aplikuesi të kontaktohet nga ana e Entit;
- (iii) pjesë që në shikim të parë duket si përshkrim.

(b) pala nënshkruese, për qëllim të datës së dorëzimit (aplikimit), mund të pranojë vizatim si element të paraparë me nënparagrafin (a)(iii).

(c) Për përcaktim të datës së dorëzimit, pala nënshkruese mund të kërkojë si element të paraparë me nënparagrafin (a)(ii) informacione që mundësojnë përcaktimin e identitetit të aplikuesit, si dhe informacione që mundësojnë që aplikuesi të mund të kontaktohet nga Enti, ose mund të pranojë dëshmi që mundëson të përcaktohet identiteti i aplikuesit ose të kontaktohet nga ana e Entit.

(2) [Gjuha] (a) Pala nënshkruese mund të kërkojë të dhënat nga paragrafi (1)(a)(i) dhe (ii) të jenë në gjuhë të pranueshme nga Enti.

(b) Pjesa e përfshirë me paragrafin (1)(a)(iii) për shkak të përcaktimit të datës së aplikimit (dorëzimit), mund të dorëzohet në çfarëdo gjuhe.

(3) [Njoftim] Kur aplikimi nuk plotëson një ose më shumë kushte të përcaktuara nga pala nënshkruese në pajtim me nenet (1) dhe (2), Enti mund, menjëherë sapo të jetë e mundur, të njoftojë aplikuesin, duke i dhënë mundësi të plotësojë çdo kusht dhe të dorëzojë vërejtje, në afat kohor të paraparë me Rregullore.

#### (4) [Plotësimi i mëvonshëm i kushteve]

(a) Kur një ose më shumë kushte që i aplikon pala nënshkruese në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) nuk janë plotësuar me aplikimet e para të dorëzuara, data e aplikimit nga

nënparagrafi (b) dhe paragrafi (6) do të jetë data në të cilën më vonë janë plotësuar të gjitha kushtet që i aplikon pala nënshkruese në pajtim me paragrafët (1) dhe (2).

(b) Pala nënshkruese mund të parashohë se, kur një ose më shumë kushte që përfshihen në nënparagrafin (a) nuk janë plotësuar në afat të paraparë me Rregullore, aplikacioni konsiderohet sikur të mos jetë dorëzuar. Kur aplikacioni konsiderohet se nuk është dorëzuar, Enti e njofton aplikuesin, duke potencuar edhe shkaqet për këtë.

(5) *[Njoftim që ka të bëjë me një pjesë të përshkrimit apo vizatimit që mungon]* Nëse pas përcaktimit të datës së dorëzimit, Enti vëren se një pjesë e përshkrimit mungon në aplikim ose se aplikimi ka të bëjë me vizatim që mungon në aplikim, Enti menjëherë e njofton aplikuesin.

(6) *[Data e dorëzimit kur dorëzohet pjesa e përshkrimit apo vizatimi që mungon]*

(a) Kur deri tek Enti dorëzohet pjesa e përshkrimit apo vizatimit që mungon, në afate të parashikuara me Rregullore, ajo pjesë e përshkrimit apo vizatimit është pjesë përbërëse e aplikacionit dhe është lëndë e nënparagrafit (b) dhe (c), data e dorëzimit të aplikimit është data në të cilin Enti ka marrë atë pjesë të përshkrimit apo vizatimit ose data në të cilën janë plotësuar të gjitha kushtet që i zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët (1) dhe (2), në varësi të asaj se cila datë është më e vonshme.

(b) Kur pjesa e përshkrimit apo vizatimit që mungon dorëzohet në pajtim me nënparagrafin (a) për të korigjuar lëshimin nga aplikimi në të cilin në datë një ose më shumë elementë të përfshirë në paragrafin (1)(a) ishin dorëzuar për herë të parë deri tek Enti, është kërkuar e drejta e prioritetit në bazë të aplikimit të mëparshëm të dorëzuar, data e dorëzimit, me kërkesë të aplikuesit, në afate të përshkruara në rregullore dhe lëndë e kushteve të përshkruara me Rregullore, do të jetë data në të cilën të gjitha kushtet që zbatohen nga pala nënshkruese të jenë plotësuar, në përputhje me nenin (1) dhe (2).

(c) Kur pjesa e përshkrimit apo vizatimit që mungon, e dorëzuar në pajtim me nënparagrafin (a), tërhiqet në afat të përcaktuar nga pala nënshkruese, data e dorëzimit të aplikacionit do të jetë data në të cilën janë plotësuar kushtet që i zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët (1) dhe (2).

(7) *[Zëvendësim i përshkrimit apo vizatimit duke iu referuar aplikimit të mëparshëm]*

(a) Në bazë të kushteve të përshkruara me Rregullore, referimi i bërë pas dorëzimit të aplikacionit, në gjuhë të pranuar nga Enti, mbi aplikacionin e mëparshëm të dorëzuar, për shkak të përcaktimit të datës së aplikacionit, e zëvendëson përshkrimin apo cilindo vizatim.

(b) Kur kushtet e përfshira në nënparagrafin (a) nuk plotësohen, aplikacioni mund të konsiderohet sikur nuk është dorëzuar. Kur aplikacioni konsiderohet se nuk është dorëzuar, Enti njofton aplikuesin, duke potencuar edhe shkaqet për këtë.

(8) *[Përjashtime]* Asgjë në këtë nen nuk do të kufizojë:

(i) të drejtën e aplikuesit, në pajtim me nenin 4d paragrafët (1) dhe (2) të Konventës së Parisit, të mbajë si datë të aplikimit të ndarë nga ai nen, datën e aplikimit të parë të potencuar në atë nen, dhe përparësinë e të drejtës së prioritetit, nëse ekziston;

(ii) lirinë e palës nënshkruese të zbatojë të gjitha kushtet e domosdoshme për përcaktimin e datës së aplikimit të mëhershëm të dorëzuar, të aplikimit të cilitdo lloj të përshkruar me Rregullore.

## Aplikimi

### Neni 6

(1) [*Forma ose përmbajtja e aplikimit*] Përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Marrëveshje, asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë plotësimin e ndonjë kushti të lidhur me formën apo përmbajtjen e aplikacionit që është shtuar apo i ndryshëm nga:

(i) Kushtet e lidhura me formën apo përmbajtjen që parashihen për aplikacionet ndërkombëtare me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave;

(ii) Kushtet e lidhura me formën apo përmbajtjen e aplikacioneve ndërkombëtare për të cilat është iniciuar harmonizimi, në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave, mund t'i kërkojë Enti i cilitdo shtet nënshkruer i asaj marrëveshje apo Enti që punon për atë shtet, pasi të filloj përpunimi apo shqyrtimi i aplikacionit ndërkombëtar, siç është paraparë me nenin 23 apo nenin 40 të marrëveshjes së cekur;

(iii) çfarëdo qofshin kushte të tjera shtesë të përshkruara me Rregullore.

(2) [*Formulari për kërkesë*]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë, përmbajtja e aplikacionit që përgjigjet me përmbajtjen e kërkesës për aplikacion ndërkombëtar në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave, të jepet në formular për kërkesë të përshkruar nga pala nënshkruese. Pala nënshkruese mund gjithashtu të kërkojë çdo lloj përmbajtje tjetër plotësuese të lejuar me paragrafin (1)(ii) ose të përshkruar në Rregullore në pajtim me paragrafin 1(iii) të përmbahet në atë formular për kërkesë.

(b) Përkundër nënparagrafit (a), ndërsa në pajtim me nenin 8 paragrafi (1), pala nënshkruese e pranon përmbajtjen në pajtim me nënparagrafin (a) të formularit për kërkesë të paraparë me Rregullore.

(3) [*Përkthimi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë përkthim të cilësdo pjesë të aplikacionit që nuk është në gjuhën e pranueshme nga Enti. Pala nënshkruese mund të kërkojë edhe përkthim të pjesëve të aplikacionit, siç është paraparë me Rregullore, që janë në gjuhë të pranueshme nga Enti dhe në çdo gjuhë tjetër të pranuar nga ai ent.

(4) [*Taksa*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesë taksash lidhur me aplikimin. Pala nënshkruese mund të aplikojë dispozitat e Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave që kanë të bëjnë me pagesën e taksave për aplikim.

(5) [*Dokument prioritar*] Kur kërkohet prioritet mbi aplikimin e mëparshëm, pala nënshkruese mund të kërkojë kopje nga aplikacioni i mëparshëm dhe përkthimin në raste kur aplikacioni i mëparshëm nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti, të dorëzohen në pajtim me kushtet e përshkruara në Rregullore.

(6) [*Dëshmia*] Pala nënshkruese mund të kërkojë të dorëzohen dëshmi që kanë të bëjnë me cilëndo çështje të përfshirë me paragrafin (1) apo paragrafin (2) ose në deklaratën e

prioritetit, ose cilido përkthim të përfshirë me paragrafin (3) apo paragrafin (5), deri tek Enti i saj gjatë shqyrtimit (përpunimit) të aplikacionit, vetëm nëse Enti ka dyshime të bazuara për vërtetësinë apo saktësinë e përkthimit.

(7) [Njoftim] Kur një ose më shumë kushte që i zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët nga (1) deri (6) nuk janë plotësuar, Enti njofton aplikuesin, duke i dhënë mundësi të plotësojë çdo kusht dhe të bëjë vërejtje, në afat të përcaktuar me Rregullore.

(8) [Mosplotësimi i kushteve]

(a) Kur një ose më shumë kushte që i zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët nga (1) deri (6) nuk janë plotësuar në afat të paraparë me Rregullore, pala nënshkruese mund, në pajtim me nënparagrafin (b) dhe nenet 5 dhe 10, të zbatojë sanksione të parapara me aktet e saja ligjore.

(b) Kur cilido kusht në lidhje me kërkesën për prioritet që e zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët (1), (5) ose (6) nuk është plotësuar në afat të paraparë me Rregullore, kërkesa për prioritet mund, në përputhje me nenin 13, të konsiderohet si joekzistuese. Në përputhje me nenin 5 paragrafi (7)(b) nuk mund të aplikohen sanksione të tjera.

## Përfaqësimi

### Neni 7

(1) [Përfaqësues]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë, përfaqësuesi i emëruar për qëllime të cilëndo procedurë para Entit:

(i) të ketë të drejtë, sipas ligjit që aplikon, të ndërmarrë veprime para Entit në lidhje me aplikimet dhe patentat;

(ii) të shënojë, si adresë të tij, adresën e territorit të përshkruar nga pala nënshkruese.

(b) Në pajtim me nënparagrafin (c) në lidhje me cilëndo procedurë para Entit, çdo veprim që ka ndërmarrë përfaqësuesi që i përmbahet kushteve që i zbaton pala nënshkruese në përputhje me nënparagrafin (a), ka efekt të veprimit të ndërmarrë nga ana e, ose në lidhje aplikuesin, bartësin ose ndonjë personit tjetër të interesuar që ka emëruar përfaqësuesin.

(c) Pala nënshkruese mund të parashohë që, në rast të betimit apo deklaratës ose tërheqjes së autorizimeve të avokatit, nënshkrimi i përfaqësuesit nuk do të ketë efekt si nënshkrimi i aplikuesit, bartësit apo ndonjë personit tjetër të interesuar që ka emëruar atë përfaqësues.

(2) [Përfaqësim i obligueshëm]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar të emëroj (përcaktojë) përfaqësues për qëllimet e cilëndo procedurë para Entit, ndërsa personi mbi të cilin është bartur aplikacioni, aplikuesi, bartësi apo person tjetër i interesuar të veprojë i pavarur para Entit në procedurat vijuese:

(i) dorëzimin e aplikacionit me qëllim përcaktimin e datës së dorëzimit;

(ii) pagesën e shpenzimeve;

(iii) çdo procedurë tjetër të paraparë me Rregullore;  
(iv) lëshimin e vërtetimit për pranim ose njoftim nga ana e Entit në lidhje me cilëndo procedurë të mbuluar nga pikat (i) deri (iii).

(b) Shpenzimet e mirëmbajtjes mund t'i paguaj çdo person.

(3) [*Emërimi i përfaqësuesit*] Pala nënshkruese pranon që emërimi i përfaqësuesit të dorëzohet deri tek Enti në mënyrë të përshkruar me Rregullore.

(4) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë të plotësohen kushte formale të ndryshme nga ato të përfshira në paragrafët nga (1) deri (3) për çështjet që janë të përmbajtura në ato paragrafë, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë marrëveshje ose nëse është përshkruar me Rregullore.

(5) [*Njoftimi*] Kur më shumë se një nga kushtet që i zbaton pala nënshkruese në lidhje me paragrafët nga (1) deri (3) nuk janë plotësuar, Enti njofton personin mbi të cilin udhëhiqet aplikimi, aplikuesin apo personin tjetër të interesuar, duke i dhënë mundësinë të plotësojë çdo lloj kushti dhe të dorëzojë vërejtje në afat të përshkruar me Rregullore.

(6) [*Mosplotësimi i kushteve*] Kur një ose më shumë kushte që i zbaton pala nënshkruese në pajtim me paragrafët nga (1) deri (3) nuk janë plotësuar në afatet e përshkruara me Rregullore, pala nënshkruese mund të zbatojë masa siç janë paraparë me legjislacionin e saj.

Parashtresa, adresa

Neni 8

(1) [*Forma dhe mënyra e parashtresave*]

(a) Përveç për përcaktimin e datës së dorëzimit të aplikacionit në përputhje me nenin 5 paragrafi (1) dhe me nenin 6 paragrafi (1), me Rregullore, në përputhje me nënparagrafët nga (b) deri (d), përcaktohen kushtet të cilat pala nënshkruese mund t'i aplikojë në lidhje me formën dhe mënyrën e bartjes së të dhënave.

(b) Asnjë nga palët nënshkruese nuk është e obliguar t'i pranojë parashtresat që nuk janë të dorëzuara në formë të shkruar.

(c) Asnjë nga palët nënshkruese nuk është e obliguar të përjashtojë dorëzimin e parashtresave në formë të shkruar.

(d) Pala nënshkruese e pranon dorëzimin e parashtresave në formë të shkruar për shkak të respektimit të afateve.

(2) [*Gjuha e parashtresave*] Pala nënshkruese, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë marrëveshje apo Rregullore, mund të kërkojë parashtresa të jetë në gjuhë të pranueshme nga Enti.

(3) [*Lloji i formularëve ndërkombëtarë*] Pa marrë parasysh paragrafin (1)(a), dhe në pajtim me paragrafin (1)(b) dhe nenin 6 paragrafi (2)(b), pala nënshkruese pranon potencimin e çdo lloj përmbajtjeje nga parashtresa në formularë që përgjigjet me llojin e formularit ndërkombëtarë për parashtresë të tillë siç është paraparë me Rregullore, në qoftë se ekziston një formular i tillë.



(4) *[Nënshkrimi i parashtresave]*

(a) Kur pala nënshkruese kërkon nënshkrim për qëllimet e cilësdo parashtresë, ajo palë nënshkruese pranon çdo nënshkrim që i plotëson kushtet e përcaktuara me Rregullore.

(b) Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë dëshmi, noterizim, vërtetim të autenticitetit, legalizim apo vërtetim tjetër për cilindo nënshkrim që është dorëzuar deri tek Enti i saj, përveç lidhur me ndonjë procedurë kvazi-gjyqësore apo në pajtim me përcaktimet e Rregullores.

(c) Në pajtim me nënparagrafin (b), pala nënshkruese mund të kërkojë dorëzimin e dëshmisë deri tek Enti, vetëm kur Enti ka dyshime të bazuara në autenticitetin e cilitdo nënshkrim.

(5) *[Të dhënat në parashtresa]* Pala nënshkruese mund të kërkojë që çdo parashtresë të përmbajë një ose më shumë të dhëna të përcaktuara me Rregullore.

(6) *[Adresa për korrespondencë, adresa për shërbime juridike dhe adresa të tjera]* Pala nënshkruese, në përputhje me dispozitat e përcaktuara me Rregullore, mund të kërkojë që aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar të potencojë në çdo parashtresë:

(i) adresën për korrespondencë;

(ii) adresën për shërbime juridike;

(iii) adresa të tjera të parapara me Rregullore.

(7) *[Njoftim]* Kur një ose më shumë nga kushtet që i aplikon pala nënshkruese në pajtim me paragrafët nga (1) deri (6) nuk janë plotësuar lidhur me parashtresat, Enti e njofton aplikuesin, bartësin apo personin tjetër të interesuar, duke i dhënë mundësi të plotësojë të gjitha këto kushte dhe të dorëzojë vërejtje, në afat të përcaktuar me Rregullore.

(8) *[Mosplotësimi i kushteve]* Kur një ose më shumë kushte që i aplikon pala nënshkruese në pajtim me paragrafët nga (1) deri (6) nuk janë plotësuar në afat të përcaktuar me Rregullore, pala nënshkruese, në pajtim me nenin 5 dhe nenin 10, dhe me përjashtimet e përshkruara në Rregullore, mund të aplikojë çdo lloj sanksioni të paraparë me aktet e saja ligjore.

## Njoftime

### Neni 9

(1) *[Njoftim i mjaftueshëm]* Çdo njoftim në pajtim me këtë marrëveshje apo me Rregulloren që është dërguar nga Enti në adresë për korrespondencë apo në adresë për shërbime juridike në pajtim me nenin 8 paragrafi (6), ose në çfarëdo adrese të paraparë me Rregullore për qëllimet e kësaj dispozite, e që është në përputhje me dispozitat lidhur me atë njoftim, është e mjaftueshme për qëllimet e kësaj marrëveshje dhe Rregullores.

(2) *[Nëse të dhënat që mundësojnë kontakt nuk janë dorëzuar]* Asgjë në këtë marrëveshje dhe në Rregullore nuk do të obligojë palën nënshkruese të dërgojë njoftim deri tek aplikuesi, bartësi ose personi tjetër i interesuar, nëse deri tek Enti nuk janë dorëzuar të dhëna që mundësojnë që të kontaktohet ai aplikuesi, bartës apo person tjetër i interesuar.

(3) [*Mosnjoftim*] Në pajtim me nenin 10 paragrafi (1), kur Enti nuk ka njoftuar aplikuesin se bartësi apo personi tjetër i interesuar nuk ka plotësuar ndonjë nga kushtet e kësaj marrëveshje apo Rregullore, ajo mungesë e njoftimit nuk e liron aplikuesin, bartësin apo personin tjetër të interesuar nga obligimi për të plotësuar atë kusht.

## Vlefshmëria e patentës; Revokimi

### Neni 10

(1) [*Vlefshmëria e patentës mbi të cilën nuk ndikon mosplotësimi i kushteve të caktuara formale*] Mosplotësimi i një ose më shumë kushteve formale në lidhje me dorëzimin e aplikacionit nga neni 6 paragrafët (1), (2),(4) dhe (5) dhe neni 8 paragrafët nga (1) deri (4), nuk mund të jetë bazë për revokimin apo anulimin e vlefshmërisë së patentës, në tërësi apo pjesërisht, përveç në raste kur mosplotësimi i kushtit formal ka ndodhur për qëllime mashtrimi.

(2) [*Mundësi për të dorëzuar vërejtje, ndryshime apo korrigjime në rast të revokimit apo anulimit të qëllimshëm të vlefshmërisë*] Vlefshmëria e një patente nuk mund të revokohet apo anulohet, në tërësi apo pjesërisht, pa mos marrë aplikuesi mundësi të dorëzojë vërejtje për qëllimin e revokimit apo anulimit të vlefshmërisë dhe në afat të arsyeshëm të shtojë ndryshime apo korrigjime nëse kjo është e lejuar me ligjin që aplikon.

(3) [*Mosekzistimi i obligimit për procedura speciale*] Paragrafët (1) dhe (2) nuk krijojnë detyrim për inicim të procedurës gjyqësore për zbatimin e të drejtave të patentës që dallojnë nga ato që përgjithësisht vlejné për zbatimin e ligjit.

## Favore në lidhje me afatet

### Neni 11

(1) [*Vazhdimi i afateve*] Pala nënshkruese mund të parashohë për një periudhë të përcaktuar me Rregullore, vazhdimin e afatit të përcaktuar nga Enti për ndërmarrjen e veprimeve në procedurë para Entit për aplikacionin ose për patentën, nëse është dorëzuar deri tek Enti kërkesë për atë qëllim, në pajtim me kushtet e përcaktuara me Rregullore, dhe nëse është dorëzuar sipas zgjedhjes së palës nënshkruese:

- (i) para skadimit të afatit ose
- (ii) pas skadimit të afatit dhe në afat të përcaktuar me Rregullore.

(2) [*Vazhdimi i procedurës*] Kur aplikuesi ose bartësi nuk respektojnë afatin e përcaktuar nga Enti i palës nënshkruese për ndërmarrjen e veprimeve në procedurën para Entit në lidhje me aplikimin ose patentën, ndërsa ajo palë nënshkruese nuk jep mundësinë për vazhdimin e afatit në pajtim me paragrafin (1)(ii), pala nënshkruese siguron vazhdimin e procedurës për aplikim ose patentë dhe, nëse është e nevojshme, rivendosjen e të drejtave të aplikuesit apo bartësit në lidhje me atë aplikacion ose patentë, nëse:

- (i) për këtë qëllim është dorëzuar kërkesë deri tek Enti në pajtim me kushtet e përshkruara me Rregullore;

(ii) është dorëzuar kërkesa dhe janë plotësuar të gjitha kushtet në lidhje me afatin e përcaktuar për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në afat të përcaktuar me Rregullore.

(3) [*Përrjashtime*] Nga asnjë palë nënshkruese nuk mund të kërkohet të jap lehtësime në pajtim me paragrafët (1) ose (2) në lidhje me përjashtimet e përshkruara në Rregullore.

(4) [*Taksa*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesë të taksave në lidhje me kërkesën në pajtim me paragrafët (1) ose (2).

(5) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë plotësim të kushteve në lidhje me përcaktimet e parashikuara me paragrafët (1) ose (2), përveç atyre të përfshira në paragrafët nga (1) deri (4), përveç nëse është paraparë ndryshe me këtë marrëveshje ose është përcaktuar ndryshe me Rregullore.

(6) [*Mundësi për dorëzimin e vërejtjeve në rast të qëllimit për refuzim*] Kërkesa në përputhje me paragrafët (1) ose (2) nuk mund të refuzohet pa mos marrë mundësi aplikuesi ose bartësi, në afat të arsyeshëm të dorëzojë vërejtje për qëllimin e refuzimit.

Rivendosje e të drejtave pasi Enti të përcaktojë se është kushtuar kujdes i veçantë ose është bërë lëshim i paqëllimshëm

## **Neni 12**

(1) [*Kërkesa*] Pala nënshkruese mund të parashohë, kur aplikuesi ose bartësi të mos ketë respektuar afatin për ndërmarrjen e veprimeve në procedurën para Entit, ndërsa pasojë e drejtpërdrejtë e lëshimit është humbja e të drejtës në lidhje me aplikimin ose patentën, që Enti sërisht t'u rivendosë të drejtat aplikuesit ose bartësit në lidhje me aplikacionin ose patentën e caktuar për të cilën bëhet fjalë, nëse:

(i) është dorëzuar deri tek Enti kërkesë për atë qëllim në pajtim me kushtet e përcaktuara me Rregullore;

(ii) është dorëzuar kërkesa në afat dhe nëse janë plotësuar të gjitha kushtet në lidhje me afatin për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, në afate të përcaktuara me Rregullore;

(iii) në kërkesë janë potencuar shkaqet për mosrespektimin e afateve; dhe

(iv) Enti bie në përfundim se mosrespektimi i afateve ka ndodhur edhe përskaj kujdesin të mjaftueshëm lidhur me rrethanat ose se, sipas zgjedhjes së palës nënshkruese, çdo shtyrje (prolongim) ka qenë i paqëllimshëm.

(2) [*Përrjashtime*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk kërkon të sigurojë rivendosjen e të drejtave dhe kthimin në gjendje të mëparshme në pajtim me paragrafin (1) në lidhje me përjashtimet e përcaktuara në Rregullore.

(3) [*Taksa*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesën e taksave në lidhje me kërkesat nga paragrafi (1).

(4) [*Dëshmi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohet deri tek Enti deklaratë ose ndonjë dëshmi tjetër si mbështetje e shkaqeve të potencuar në paragrafin (1)(iii), në afat të përcaktuar nga ana e Entit.

(5) [Mundësi për vërejtje në rast të qëllimit për refuzim] Kërkesa në pajtim me paragrafin (1) nuk mund të refuzohet në tërësi apo pjesërisht, pa mos fituar mundësi pala që dorëzon kërkesën të deklarohet për qëllimin e refuzimit, në afat të arsyeshëm kohor.

Korrigjimi ose plotësimi i kërkesës për të drejtën e prioritetit;  
Ripërtëritja (Rinovimi) e së drejtës së prioritetit

### Neni 13

(1) [Korrigjimi ose plotësimi i kërkesës për të drejtën e prioritetit] Përveç nëse është paraparë ndryshe me Rregullore, pala nënshkruese parasheh korrigjim apo plotësim të kërkesës për të drejtën e prioritetit në lidhje me aplikimin për patentë (“aplikimi i mëvonshëm”), nëse:

- (i) kërkesa për atë qëllim është dorëzuar deri tek Enti në pajtim me kushtet e parapara me Rregullore;
- (ii) Kërkesa është dorëzuar në afat të përcaktuar me Rregullore; dhe
- (iii) Data e dorëzimit të aplikimit të mëvonshëm nuk është më vonë se data e skadimit të periudhës së prioritetit llogaritur nga data e dorëzimit të aplikimit të mëhershëm mbi të cilën kërkohet e drejta e prioritetit.

(2) [Dorëzimi i vonuar i aplikimit të mëvonshëm] Duke marrë parasysh nenin 15, pala nënshkruese parasheh, kur aplikacioni (“aplikimi i mëvonshëm”) për të cilën kërkohet ose mund të kërkohet e drejta e prioritetit nga aplikimi i mëhershëm ka datë të dorëzimit e cila është më e vonshme nga data në të cilën ka skaduar periudha e prioritetit, në afat të përcaktuar me Rregullore, Enti të rinovojë të drejtën e prioritetit nëse:

- (i) dorëzohet para Entit kërkesë për atë qëllim në pajtim me kushtet e përcaktuara në Rregullore;
- (ii) kërkesa është dorëzuar në afatin e përcaktuar me Rregullore;
- (iii) në kërkesë janë potencuar shkaqet për mosrespektimin e periudhës së prioritetit; dhe
- (iv) Enti konkludon se mosdorëzimi i aplikimit të mëvonshëm në periudhën e prioritetit ka ndodhur edhe përskaj kujdesin të treguar në pajtim me rrethanat ose se, sipas zgjedhjes së palës nënshkruese, ka qenë i paqëllimshëm.

(3) [Mosdorëzimi i kopjes (dokumentit) së aplikimit të mëparshëm] Pala nënshkruese parasheh që, kur kopja e aplikacionit të mëparshëm në pajtim me nenin 6 paragrafi (5) nuk është dorëzuar deri tek Enti në afatin e përcaktuar me Rregullore dhe në pajtim me neni 6, Enti e rinovon të drejtën e prioritetit, nëse:

- (i) është dorëzuar kërkesë për atë qëllim deri tek Enti në përputhje me kushtet e përcaktuara me Rregullore;
- (ii) kërkesa është dorëzuar në afatin për dorëzimin e kopjes së aplikacionit të mëparshëm të përshkruar me Rregullore në përputhje me nenin 6 paragrafi (5);
- (iii) Enti bie në përfundim se kërkesa për kopjen që duhet të dorëzohet është dorëzuar deri tek Enti në të cilën është dorëzuar edhe aplikacioni i mëparshëm, në afat të përcaktuar me Rregullore; dhe
- (iv) kopja e aplikimit të mëparshëm është dorëzuar në afat të përcaktuar me Rregullore.

(4) [*Taksa*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesën e taksave në lidhje me kërkesën nga paragrafët nga (1) deri (3).

(5) [*Dëshmi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë deklaratë ose dëshmi tjetër si mbështetje të shkaqeve të cekura në paragrafin (2)(iii) të dorëzohen para Entit në afat të përcaktuar nga Enti.

(6) [*Mundësi për deklaram në rast të qëllimit për refuzim*] Kërkesa në përputhje me paragrafët nga (1) deri (3) nuk mund të refuzohet në tërësi ose pjesërisht, pa mos fituar mundësinë pala që dorëzon kërkesën të deklarohet për qëllimin për refuzim, në afat të arsyeshëm.

## Rregullore

### Neni 14

(1) [Përmbajtja]

(a) Rregullorja pranë kësaj Marrëveshje i parasheh dispozitat në lidhje me:

(i) çështjet për të cilat në këtë marrëveshje qartë potencohet se janë “të përcaktuara (përshkruara) në Rregullore”;

(ii) detajet që janë të dobishme për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje;

(iii) kërkesa, çështje apo procedura administrative.

(b) Rregullorja, gjithashtu parasheh dispozita në lidhje me kushtet formale që pala nënshkruese mund t'i zbatojë në kërkesat për:

(i) regjistrimin (evidentimin) e ndryshimit të emrit ose adresës;

(ii) regjistrimin e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit;

(iii) regjistrimin e licencës ose sigurimin e kërkesave;

(iv) korrigjimin e gabimit.

(c) Rregullorja, gjithashtu parasheh se Kuvendi me ndihmën e Byrosë ndërkombëtare përcakton llojin e formularëve ndërkombëtar dhe formularit për dorëzimin e kërkesës lidhur me nenin 6 paragrafi (2)( b).

(2) [Ndryshimi i Rregullores] Lëndë e paragrafit (3), çdo ndryshim i Rregullores kërkon tri të katërtat e votave.

(3) [Kushti i unanimitetit]

(a) Me rregullore mund të specifikohen dispozitat e Rregullores të cilat mund të ndryshohen vetëm unanimitet.

(b) Për çdo ndryshim të Rregullores, rezultat i së cilit janë dispozita shtesë ose fshirje të dispozitave të specifikuara në Rregullore në përputhshmëri me nënparagrafin (a) kërkohet unanimitet.

(c) Gjatë përcaktimit se a është arritur unanimitet, vetëm votat e dhëna do të merren parasysh. Të përmbajturat nuk do të konsiderohen për vota.

(4) [Mospërputhje midis Marrëveshjes dhe Rregullores] Në rast të mospërputhjes midis dispozitave të kësaj marrëveshje dhe atyre të Rregullores, zbatohen dispozitat e Marrëveshjes.

Ndërlidhshmëri me Konventën e Parisit

### Neni 15

(1) [Detyrimi për të respektuar Konventën e Parisit] Çdo palë nënshkruese duhet t'i përmbahet dispozitave të Konventës së Parisit lidhur me patentat.

(2) [Detyrime dhe të drejta në pajtim me Konventën e Parisit]

(a) Asgjë në këtë marrëveshje nuk i largon nga detyrimi që palët nënshkruese i kanë sipas Konventës së Parisit.

(b) Asgjë në këtë marrëveshje nuk i anulon të drejtat që i gëzojnë aplikuesit dhe bartësit sipas Konventës së Parisit.

Aplikimi i rishikimeve, ndryshimeve dhe plotësimeve të  
Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave

## Neni 16

(1) [*Aplikimi i rishikimeve, amandamentimeve dhe ndryshimeve të Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave*] Në pajtim me paragrafin (2), çdo rishikim, ndryshim apo plotësim i Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave që është në pajtim me këtë marrëveshje, e bërë pas 2 qershorit të vitit 2000, zbatohet për qëllimet e kësaj marrëveshje dhe Rregullores nëse Kuvendi në rastin konkret vendos kështu me tri të katërtat e votave.

(2) [*Moszbatimi i dispozitave kalimtare të Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave*] Çdo dispozitë e Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave, në bazë të cilës dispozita e rishikuar, ndryshuar apo plotësuar e asaj marrëveshje nuk zbatohet në shtetin i cili është anëtarë i asaj marrëveshje ose i Entit që punon për atë shtet, derisa dispozita e dytë nuk është në përputhje (harmonizim) me ligjin që zbatohet nga ana e atij shteti apo Enti, nuk do të zbatohet për qëllime të kësaj Marrëveshje dhe Rregullore.

Kuvendi

## Neni 17

(1) [*Përbërja*]

(a) Palët nënshkruese kanë Kuvend.

(b) Çdo palë nënshkruese përfaqësohet në Kuvend me një delegat të cilit mund t'i ndihmojnë zëvendës, këshilltarë dhe ekspertë. Çdo delegat mund të përfaqësojë vetëm një palë nënshkruese.

(2) [*Detyra*] Kuvendi:

(i) merret me çështje që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kësaj marrëveshje dhe zbatimin dhe funksionimin e kësaj marrëveshje;

(ii) me ndihmën e Byrosë ndërkombëtare përcakton llojin e formularëve ndërkombëtar dhe formularëve për kërkesa, në pajtim me nenin 14 paragrafi (1)(c);

(iii) ndryshon Rregulloren;

(iv) përcakton kushtet për datën e dorëzimit të aplikacionit për çdo lloj formulari ndërkombëtarë dhe për formularët për kërkesa nga pika (ii) dhe çdo ndryshim nga pika (iii);

(v) vendos, në pajtim me nenin 16 paragrafi (1), se a zbatohet ndonjë rishikim, ndryshim apo plotësim i Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave, për qëllimet e kësaj marrëveshjeje dhe Rregullore;

(vi) kryen funksione të tjera të nevojshme në përputhje me Marrëveshjen.

(3) [*Kuorum*]

(a) Gjysma e anëtarëve të Kuvendit, që janë shtete, e përbëjnë kuorumin.  
(b) Pa marrë parasysh nënparagrafin (a), nëse në ndonjë seancë, numri i anëtarëve, të cilat janë shtete, të përfaqësuara në Kuvend është më i vogël se gjysma, por është i barabartë ose më shumë se një e treta e shteteve anëtare të Kuvendit, Kuvendi mund të sjellë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me vetë procedurën e saj, të gjitha këto vendime hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet të përcaktuara në tekstin e mëposhtëm. Byroja ndërkombëtare dorëzon vendimet e cekura deri tek shtetet anëtare të Kuvendit të cilat nuk janë përfaqësuar dhe i fton në formë të shkruar të japin votën e tyre ose të përmbahen nga votimi në periudhë prej tre muajsh nga data e dorëzimit. Nëse pas skadimit të kësaj periudhe, numri i anëtarëve që kanë dhënë votën e tyre ose që janë deklaruar si të përmbajtur e arrin numrin e anëtarëve që ka munguar për të arritur kuorum në vetë seancën., vendimet e këtilla hyjnë në fuqi, me kusht që njëkohësisht të arrihet edhe shumica e nevojshme.

(4) [*Sjellja e vendimeve në Kuvend*]

(a) Kuvendi synon të sjellë vendime me konsensus.

(b) Kur vendimi nuk mund të arrihet me konsensus, çështja për të cilën bëhet fjalë zgjidhet me votim. Në atë rast:

(i) çdo palë nënshkruese që është shtet ka të drejtë në një votë dhe voton vetëm në emër të vet personal; dhe

(ii) çdo palë nënshkruese që është organizatë ndërqeveritare mund të merr pjesë në votim, në emër të shtetit të vet anëtar, me numër të votave të barabartë me numrin e shteteve që janë palë në këtë marrëveshje. Organizata e tillë ndërqeveritare nuk guxon të marrë pjesë në votim nëse ndonjëra nga shtetet e saj anëtare, palë në këtë marrëveshje, është anëtare e një organizate tjetër ndërqeveritare dhe ajo organizatë ndërqeveritare merr pjesë në votim.

(5) [*Shumica*]

(a) Në pajtim me nenin 14 paragrafi (2) dhe paragrafi (3), neni 16 paragrafi (1) dhe neni 19 paragrafi (3), vendimet e Kuvendit kërkojnë shumicë prej dy të tretave të votave.

(b) Gjatë përcaktimit se a është arritur shumica e nevojshme, vetëm votat e konkretisht janë dhënë merren parasysh. Të përmbajturit nuk konsiderohen për vota.

(6) [*Seanca*] Kuvendi, të cilin e thërret drejtori gjeneral, mbledhet në seanca të rregullta në çdo dy vite.

(7) [*Rregulla të procedurës*] Kuvendi vendos rregulla të veta të procedurës, përfshirë edhe rregulla për thirrjen e seancave të jashtëzakonshme.

## **Byroja ndërkombëtare**

### **Neni 18**

(1) [*Detyra administrative*]

(a) Byroja ndërkombëtare kryen detyra administrative që kanë të bëjnë me këtë marrëveshje.

(b) Byroja ndërkombëtare në mënyrë të veçantë i përgatit mbledhjet dhe vepron si sekretariat i Kuvendit dhe atyre komiteteve të ekspertëve dhe grupeve të punës që mund t'i formojë Kuvendi.



(2) [Takime që nuk janë mbledhje të Kuvendit] Drejtori gjeneral thërret të gjitha komitetet dhe grupet e punës të formuara nga Kuvendi.

(3) [Roli i Byrosë ndërkombëtare në Kuvend dhe takimet tjera]

(a) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga drejtori gjeneral marrin pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha takimet e Kuvendit, komiteteve dhe grupeve punuese, të formuara nga ana e Kuvendit.

(b) Drejtori gjeneral ose personi i emëruar nga drejtori gjeneral, sipas detyrës zyrtare është sekretar i Kuvendit, komiteteve dhe grupeve punuese, në pajtim me nënparagrafin (a).

(4) [Konferenca]

(a) Byroja ndërkombëtare në përputhje me udhëzimet e Kuvendit, kryen përgatitje për çdo konferencë reviduese (rishikuese).

(b) Byroja ndërkombëtare mund të konsultohet me shtet anëtarë të Organizatës, organizata ndërqeveritare dhe organizata joqeveritare nacionale dhe ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet e lartshënuara.

(c) Drejtori gjeneral dhe personi i emëruar nga drejtori gjeneral marrin pjesë, pa të drejtë vote, në bisedimet e konferencave rishikuese.

(5) [Detyra të tjera] Byroja ndërkombëtare kryen edhe detyra të tjera që i caktohen në lidhje me këtë marrëveshje.

## Rishikime

### Neni 19

(1) [Rishikime të Marrëveshjes] Në pajtim me paragrafin (2), kjo marrëveshje mund të rishikohet në konferencë të palëve nënshkruese. Për thirrjen e çdo konference vendos Kuvendi.

(2) [Rishikimi ose ndryshimi i dispozitave të caktuara në Marrëveshje] Neni 17 paragrafi (2) dhe paragrafi (6) mund të ndryshohet ose me konferencë rishikuese ose nga ana e Kuvendit, në pajtim me dispozitat e paragrafit (3).

(3) [Ndryshim i dispozitave të caktuara të Marrëveshjes nga ana e Kuvendit]

(a) Propozime për ndryshime nga ana e Kuvendit të nenit 17 paragrafi (2) dhe paragrafi (6) mund të iniciojë çdo palë nënshkruese ose drejtori gjeneral. Propozimet e këtilla i dorëzohen drejtorit gjeneral të palëve nënshkruese gjashtë muaj para shqyrtimit të tyre në Kuvend.

(b) Miratimi i çdo ndryshimi të dispozitave sipas nënparagrafit (a) kërkon shumicë prej tri të katërtave të votave.

(c) Çdo ndryshim i dispozitave në përputhje me nënparagrafin (a) hyn në fuqi pas kalimit të një muaji pasi drejtori gjeneral të pranojë, nga tri të katërtat e shteteve që në momentin e miratimit të ndryshimeve kanë qenë anëtarë të Kuvendit, njoftim në formë të shkruar për pranimin e pranimit të miratimeve në përputhje me procedurat e përcaktuara me kushtetuta të shteteve anëtarë. Çdo ndryshim i dispozitave të lartpërmendura të pranuar në atë mënyrë i obligon të gjitha palët nënshkruese në momentin e hyrjes në

fuqi të ndryshimeve në shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që bëhen palë nënshkruese në një datë më të vonshme.

Të bërit palë e Marrëveshjes

## Neni 20

(1) [Shtetet] Çdo shtet që është palë e Konventës së Parisit ose që është anëtar e Organizatës dhe për të cilën mund të njihen patenta, ose përmes Entit të shtetit ose përmes Entit të shteti tjetër ose organizate ndërqeveritare, mund të bëhet palë (pjesë) e kësaj marrëveshje.

(2) [Organizata ndërqeveritare] Çdo organizatë ndërqeveritare mund të bëhet pjesë e kësaj marrëveshje nëse të paktën një shtet anëtar e asaj organizate ndërqeveritare është palë e Konventës së Parisit ose anëtar e Organizatës, dhe nëse organizata ndërqeveritare jep deklaratë se është e autorizuar, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, të bëhet palë e Marrëveshjes, dhe nëse jep deklaratë se:

(i) është përgjegjëse (e autorizuar) të njohë patenta me efekt mbi shtetet e saj anëtare; ose

(ii) është kompetente për çështje që janë mbuluar me këtë marrëveshje dhe ka legjislacion të vetin që i obligon të gjitha shtetet anëtare në lidhje me këto çështje dhe ka, ose ka obliguar entin regjional për qëllimet e njohjes së patentave me efekt mbi territorin e saj në pajtim me atë legjislacion.

Në pajtim me paragrafin (3), çdo deklaratë e tillë jepet në kohën e dorëzimit të dokumentit për ratifikim ose aderim (qasje).

(3) [Organizatë regjionale për patenta] Organizata Evropiane për patenta, Organizata Euro-Aziateke për patenta dhe Organizata regjionale Afrikane për pronësi industriale, që kanë dhënë deklaratë në përputhje me paragrafët (2)(i) ose (ii) në Konferencën Diplomateke në të cilën është miratuar kjo marrëveshje, mund të bëhen pjesë e kësaj marrëveshje si organizata ndërqeveritare, nëse deklarojnë, në kohën e dorëzimit të dokumentit për ratifikim ose aderim, se janë të autorizuar, në përputhje me procedurat e brendshme të veta, të bëhen palë e kësaj marrëveshje.

(4) [Ratifikimi ose aderimi] Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që i plotëson kushtet nga paragrafi (1), (2) ose (3) mund të dorëzojë:

(i) dokument për ratifikim nëse e ka nënshkruar këtë marrëveshje; ose

(ii) dokument për aderim (qasje) nëse nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje.

Hyrja në fuqi; Data e hyrjes në fuqi të ratifikimit dhe aderimit

## Neni 21

(1) [Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje] Kjo marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pasi dhjetë dokumente për ratifikim ose aderim nga ana e shteteve janë dorëzuar deri tek drejtori gjeneral.

(2) [Datat e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve] Kjo marrëveshje obligon:

(i) dhjetë shtete nga paragrafi (i) nga date në të cilën kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi  
(ii) çdo shtet tjetër, pas kalimit të tre muajve pas datës në të cilën shteti ka dorëzuar dokumentin e tij të ratifikimit ose aderimit deri tk drejtori gjeneral, ose nga cilado datë e mëvonshme e potencuar në atë dokument, por jo më shumë se gjashtë muaj pas datës së këtij dorëzimi;

(iii) Organizata Evropiane për Patenta, Organizata Euro-Aziate për patenta dhe Organizata regjionale Afrikane për pronësi industriale, pas skadimit të tre muajve pas dorëzimit të dokumentit të tyre për ratifikim ose aderim ose nga cilado datë e mëvonshme e potencuar në atë dokument, por jo më shumë se gjashtë muaj pas datës së dorëzimit të këtillë, nëse dokumenti i tillë është dorëzuar pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, në përputhje me paragrafin (1), ose tre muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje nëse dokumenti i tillë është dorëzuar para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje;

(iv) çdo organizatë tjetër ndërqeveritare që i plotëson kushtet për t'u bërë palë e kësaj marrëveshje, pas skadimit të afatit prej tre muajsh pas dorëzimit të këtij dokumenti të ratifikimit ose aderimit, ose nga cilado datë e mëvonshme e potencuar në atë dokument, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së dorëzimit të këtillë.

Zbatimi i Marrëveshjes për aplikimet e dorëzuara dhe patentat e pranuar (njohura)

## Neni 22

(1) [Parim] Në përputhje me paragrafin (2), pala nënshkruese zbaton dispozitat kësaj marrëveshje dhe Rregullores, përveç nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) dhe dispozitat nga Rregullorja të ndërlidhura me to, të aplikimeve që janë në procedurë dhe të patentave që janë në fuqi, në datën në të cilën kjo marrëveshje e obligon palën nënshkruese në pajtim me nenin 21.

(2) [Procedurat] Asnjë nga palët nënshkruese nuk është e obliguar të zbatojë dispozitat e kësaj marrëveshje apo Rregullore mbi çfarëdo veprimi në procedurë në lidhje me aplikacionet ose patentat në pajtim me paragrafin (1), nëse procedura e tillë ka filluar para datës në të cilën kjo marrëveshje e obligon palën nënshkruese sipas neni 21.

Rezerva

## Neni 23

(1) [Rezerva] Çdo palë nënshkruese ose organizatë ndërqeveritare mund të deklarojë rezerva se dispozitat nga neni 6 paragrafi (1) nuk do të zbatohen mbi asnjë kusht në lidhje me unitetin e shpikjes të zbatueshme në aplikacionin ndërkombëtar sipas Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave.

(2) [Modalitete] Çdo rezervë në lidhje me paragrafin (1) dorëzohet në deklaratë bashkë me dokumentin për ratifikim ose aderim në këtë marrëveshje, nga ana e shtetit ose organizatës ndërqeveritare e cila e deklaron atë rezervë.

(3) [Tërheqja] Çdo rezervë lidhur me nenin (1) mund të tërhiqet në çdo moment.

(4) [Ndalesë për rezerva të tjera] Nuk janë të lejuara rezerva në këtë marrëveshje përveç rezervave të lejuara me paragrafin (1).

## Anulimi i Marrëveshjes

### Neni 24

(1) [Njoftim] Çdo palë nënshkruese mund të tërhiqet (largohet) nga kjo marrëveshje përmes njoftimit deri tek Drejtori Gjeneral.

(2) [Data e hyrjes në fuqi] Çdo tërheqje (largim) hyn në fuqi një vit nga data kur drejtori gjeneral ka pranuar njoftimin ose në cilëndo datë të mëvonshme të potencuar në njoftim. Anulimi nuk do të ketë ndikim mbi zbatimin e kësaj marrëveshje për aplikacionet për të cilat procedurat janë në vijim, e as për patentat të cilat në momentin kur largimi hyn në fuqi, vlejnë për palën nënshkruese e cila tërhiqet nga Marrëveshja.

## Gjuhët e Marrëveshjes

### Neni 25

(1) [Tekste autentike] Kjo marrëveshje nënshkruhet në një dokument origjinal në gjuhë angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle dhe ndërkohë të gjitha tekstet janë njëtrajtësisht dhe saktësisht autentik.

(2) [Tekstet zyrtare] Tekstin zyrtar në cilëndo gjuhë përveç nga paragrafi (1) e vërteton drejtori gjeneral pas konsultimeve me palët e interesuara. Për qëllimet e këtij paragrafi, pala e interesuar do të thotë çdo shtet që është palë e Marrëveshjes, ose i plotëson kushtet për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes në pajtim me nenin 20 paragrafi (1), për gjuhën zyrtare të të cilit bëhet fjalë, ose një prej gjuhëve zyrtare, si edhe Organizata Evropiane për patenta, Organizata Euro-Aziateke për patenta dhe Organizata regjionale Afrikane për pronësi industriale dhe cilado organizatë ndërqeveritare tjetër që është palë në këtë marrëveshje ose mund të bëhet pjesë e Marrëveshjes, nëse bëhet fjalë për një nga gjuhët e tyre zyrtare.

(3) [Përparësi e teksteve autentike] Në rast të mendimeve të ndryshme për interpretimin midis teksteve autentike dhe teksteve zyrtare, tekstet autentike kanë përparësi.

## Nënshkrimi i marrëveshjes

### Neni 26

Marrëveshja ngelet e hapur për nënshkrim nga ana e cilitdo shtet që i plotëson kushtet për t'u bërë pale e marrëveshjes nga neni 20 paragrafi (1), nga Organizata Evropiane për patenta, Organizata Euro-Aziateke për patenta dhe Organizata regjionale Afrikane për pronësi industriale në selinë e Organizatës, një vit pas miratimit të saj.

Depozitar; Regjistrimi

**Neni 27**

- (1) [*Depozita*] Drejtori gjeneral është depozitar i kësaj marrëveshje.
- (2) [*Regjistrimi*] Drejtori gjeneral e regjistron këtë marrëveshje në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara.

# RREGULLORE PËR MARRËVESHJEN PËR TË DREJTËN E PATENTËS

Në fuqi nga 1 janari i vitit 2006

## SHPREHJE TË SHKURTUARA

### Rregulli 1

(1) [„Marrëveshje“; „Neni“]

(a) Në këtë rregullore, fjala “marrëveshje” do të thotë Marrëveshja për të drejtën e patentës.

(b) Në këtë rregullore, fjala “neni” ka të bëjë me neni konkret të Marrëveshjes.

(2) [*Shprehje të shkurtuara të definuara me Marrëveshje*] Shprehjet e shkurtuara të definuara në nenin 1 për qëllimet e kësaj marrëveshje kanë të njëjtin kuptim edhe për qëllimet e Rregullores.

Detaje në lidhje me datën e dorëzimit sipas nenit 5

### Rregulli 2

(1) [*Afatet sipas nenit 5 paragrafit (3) dhe paragrafit (4)(b)*] Në bazë të paragrafit (2), afatet në nenin 5 paragrafi (3) dhe paragrafi (4)(b) nuk guxon të jenë më të shkurtë se dy muaj nga data e njoftimit në përputhje me neni n5 paragrafi (3).

(2) [*Përjashtim nga afati sipas nenit (4)(b)*] Kur nuk është lëshuar njoftim në pajtim me nenin 5 paragrafi (3), meqenëse nuk janë dorëzuar të dhëna që mundësojnë Enti të bie në kontakt me aplikuesin, afati nga neni 5 paragrafi (4)(b) nuk është më i shkurtë se dy muaj nga data në të cilën për herë të parë nga Enti janë pranuar ose dy elementë nga neni 5 paragrafi (1)(a)

(3) [*Afatet nga neni (6)(a) dhe (b)*]

Afatet nga neni 5 paragrafi (6)(a) dhe (b) vlejné:

(i) kur është dërguar njoftim në pajtim me nenin 5 paragrafi (5), jo më herët se dy muaj nga data e njoftimit;

(ii) kur nuk është dërguar njoftim, jo më herët se dy muaj nga data në të cilën për herë të parë nga Enti janë pranuar një ose dy elementë nga neni 5 paragrafi (1)(a).

(4) [*Kushtet sipas nenit (6)(b)*] Çdo palë nënshkruese mund, në pajtim me rregullin 4 paragrafi (3), me qëllim përcaktimin e datës së dorëzimit sipas nenit 5 paragrafi (6)(b) të kërkojë:

(i) të dorëzohet kopje e aplikacionit të mëparshëm në afat që zbatohet në pajtim me paragrafin (3);

(ii) kopje nga aplikacioni i mëparshëm dhe data e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm, të vërtetuara si të sakta nga ana e Entit në të cilin aplikimi i mëparshëm është dorëzuar, të dorëzohen në thirrje të Entit në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se katër muaj nga data e thirrjes ose në afatin që zbatohet sipas rregullit 4 paragrafi (1), në varësi të asaj se cili afat skadon më parë;

(iii) kur aplikacioni i mëparshëm nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti, përkthimi i aplikacionit të mëparshëm dorëzohet në afat që është në përputhje me paragrafin (3);

- (iv) pjesa e munguar e përshkrimit ose vizatim i munguar në tërësi të përmbahet në aplikacionin e mëparshëm;
- (v) aplikacioni, në datën në të cilën një ose më shumë elementë nga neni 5 paragrafi (1)(a) për herë të parë janë pranuar nga ana e Entit, të përmbajë të dhënë se përmbajtja e aplikacionit të mëparshëm ka qenë me thirrje të përfshirë në aplikacion;
- (vi) në afatin nga paragrafi (3) të dorëzohet informacion për atë se ku, në aplikacionin e mëparshëm ose në përkthimin nga pika (iii), është i përmbajtur pjesa e munguar e përshkrimit ose vizatimi i munguar.

(5) *[Kushtet sipas nenit 5 paragrafi (7)(a)]*

- (a) Referimi i aplikacionit të mëparshëm nga neni 5 paragrafi (7)(a) tregon se për qëllimet e datës së dorëzimit, përshkrimi ose cili do vizatim janë ndryshuar me referimin e aplikacionit të mëparshëm; Referimi, gjithashtu, tregon numrin e atij aplikacioni dhe Entin në të cilin ai aplikacion është dorëzuar. Pala nënshkruese mund të kërkojë që referenca, gjithashtu, të tregojë datën e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm.
- (b) pala nënshkruese mund gjithashtu, në pajtim me rregullin paragrafi (3) të kërkojë:

- (i) kopje nga aplikacioni i mëhershëm dhe, kur aplikacioni i mëparshëm nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti, përkthimin e atij aplikacioni të mëparshëm, të dorëzohen para Entit në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se dy muaj nga data në të cilën aplikacionin e përmbajtur në referencë në pajtim me nenin 5 paragrafi (7)(a) e ka pranuar Enti;
- (ii) të dorëzohet deri tek Enti kopje e vërtetuar të aplikacionit të mëparshëm në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se katër muaj nga data e pranimit të aplikacionit që përmban referencë në pajtim me nenin 5 paragrafi (7)(a).

- (c) Pala nënshkruese mund të kërkojë që referenca sipas nenit 5 paragrafi (7)(a) të kryhet në aplikacionin e mëparshëm që është dorëzuar nga ana e aplikuesit ose paraardhësit të tij juridik apo trashëguesit juridik.

(6) *[Përjashtime sipas nenit 5 paragrafi (8)(ii)]* Lloje të aplikacioneve sipas nenit 5 paragrafi (8)(ii) janë:

- (i) aplikacione të ndara;
- (ii) aplikacioni për vazhdim ose vazhdim të pjesërishëm;
- (iii) aplikacione nga aplikuesi të ri të përcaktuar si kompetent për shpikjen e përmbajtur në aplikacionin e mëparshëm.

Detaje në lidhje me aplikacionin në pajtim me nenin 6 paragrafët (1), (2) dhe(3)

### Rregulli 3

(1) *[Kërkesa shtesë në pajtim me nenin 6 paragrafi (1)(iii)]*

- (a) Pala nënshkruese mund të kërkojë aplikuesi që dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si aplikacion i ndarë në pajtim me rregullin 2 paragrafi (6)(i) të potencojë:

- (i) se dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si i tillë;
- (ii) numrin dhe datën e dorëzimit të aplikacionit nga i cili është ndarë ai aplikacion.

- (b) Pala nënshkruese mund të kërkojë aplikuesi që dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si aplikacion në përputhje me rregullin 2 paragrafi (6)(iii) të potencojë:

- (i) se dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si i tillë;
- (ii) numrin dhe datën e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm.

(c) Pala nënshkruese mund të kërkojë që aplikuesi i cili dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si aplikacion për patentë shtesë (plotësuese) të potencojë:

- (i) se dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si i tillë;
- (ii) numrin dhe datën e dorëzimit të aplikacionit bazë.

(d) Pala nënshkruese mund të kërkojë që aplikuesi i cili dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si aplikacion për vazhdim ose vazhdim të pjesërishëm të aplikacionit të mëparshëm, të potencojë:

- (i) se dëshiron që aplikacioni të konsiderohet si i tillë;
- (ii) numrin dhe datën e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm.

(e) Kur pala nënshkruese është organizatë ndërqeveritare, ajo mund të kërkojë që në aplikacion të potencohet:

- (i) kërkesë se aplikuesi kërkon njohje të patentës regjionale;
- (ii) Shteti anëtarë i asaj organizate ndërqeveritare në të cilën kërkohet mbrojtja e shpikjes.

(2) [formularë për kërkesa sipas nenit 6 paragrafi (2)(b)]

Pala nënshkruese pranon përmbajtjen e dhënë në përputhje me nenin 6 paragrafin (2)(a):

- (i) të formularit të kërkesës, nëse ai formular përgjigjet në kërkesën në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave dhe çfarëdo ndryshimi në përputhje me rregullin 20 paragrafi (2);
- (ii) të formularit për kërkesë, nëse ai formular është shoqëruar me shenjë se aplikuesi kërkon që aplikacioni të konsiderohet si aplikacion nacional ose regjional, ndërkohë që formulari për kërkesë konsiderohet se përfshin ndryshime në pajtim me pikën (i);
- (iii) të formularit për kërkesë nga Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e patentave që përmban shenjë (tregues) se aplikuesi kërkon aplikacioni të konsiderohet si aplikacion nacional ose regjional, nëse formulari i tillë për kërkesë është në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën patentave.

(3) [Kërkesë sipas nenit 6 paragrafi (3)] Pala nënshkruese mund të kërkojë, në përputhje me nenin 6 paragrafi (3), përkthim të emërimit, kërkesave për patenta dhe të abstraktit të aplikacionit të dorëzuar në gjuhë të pranuar nga Enti, në cilëndo gjuhë tjetër të pranuar nga Enti.

Qasje në aplikacionin e mëparshëm sipas nenit 6 paragrafi (5) dhe rregullit 2 paragrafi (4) ose aplikacionin e mëhershëm sipas rregullit 2 paragrafi (5)(b)

#### Rregulli 4

(1) [Kopje nga aplikacioni i mëparshëm në pajtim me nenin 6 paragrafi (5)] Në përputhje me paragrafin (3), pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohet deri tek Enti kopje



e aplikacionit të mëhershëm në pajtim me nenin 6 paragrafi (5), në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se 6 muaj nga data e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm ose, kur ekziston më shumë se një aplikacion i tillë i mëparshëm, nga data më e hershme e dorëzimit të atyre aplikacioneve.

(2) [Vërtetimi] Në bazë të paragrafit (3), pala nënshkruese mund të kërkojë që kopjet sipas paragrafit (1) dhe data e dorëzimit të aplikacionit të mëparshëm të vërtetohen si të sakta nga ana e Entit në të cilin është dorëzuar aplikacioni i mëparshëm.

(3) [Qasje në aplikacionin e mëparshëm ose aplikacionin e mëhershëm të dorëzuar] Nga pala nënshkruese nuk mund të kërkojë të dorëzojë kopje të vërtetuar të aplikacionit të mëparshëm ose vërtetim të datës së dorëzimit, nga paragrafët (1) dhe (2) dhe rregullit 2 paragrafi (4), ose kopje të vërtetuar të aplikacionit të mëhershëm të dorëzuar nga rregulli 2 paragrafi (5)(b), kur aplikacioni i mëparshëm ose aplikacioni i mëhershëm i dorëzuar është dorëzuar në entin e saj, ose është në dispozicion tek ai Ent në bibliotekën digjitale që është e përfshirë nga Enti për atë qëllim.

(4) [Përkthimi] Kur aplikacioni i mëparshëm nuk është dorëzuar në gjuhë të pranuar nga Enti, ndërsa vlefshmëria e të drejtës së kërkuar të prioritetit është i rëndësishëm për përcaktimin e asaj se a mund që shpikja për të cilën bëhet fjalë të mbrohet me patentë, pala nënshkruese mund të kërkojë përkthim të aplikacionit të mëparshëm nga paragrafi (1), të dorëzohet nga aplikuesi, pas thirrjes (ftesës) nga Enti apo trupi tjetër përgjegjës, në afat që nuk mund të jetë më i shkurtë se dy muaj nga data e thirrjes (ftesës), dhe jo më i shkurtë se afati, nëse është paraparë ashtu dhe aplikohet sipas paragrafit (1).

Dëshmia sipas nenit 6 paragrafi (6) dhe nenit 8 paragrafi (4)(c) dhe rregullit 7 paragrafi (4), rregullit 15 paragrafi (4), rregullit 16 paragrafi (6), rregullit 17 paragrafi (6) dhe rregullit 18 paragrafi (4)

#### Rregulli 5

Kur Enti njofton aplikuesin, bartësin apo personin tjetër të interesuar se kërkojë dëshmi në përputhje me nenin 6 paragrafi (6) ose nenin 8 paragrafi (4)(c) ose rregullin 7 paragrafi (4), rregullin 15 paragrafi (4), rregullin 16 paragrafi (6), rregullin 17 paragrafi (6) dhe rregullin 18 paragrafi (4), në njoftim potencohet arsyeja për çka Enti dyshon në vërtetësinë e përmbajtjes, të dhënës apo nënshkrimit, ose në varësi të rastit, të saktësisë së përkthimit.

Afatet që kanë të bëjnë me aplikacionin sipas nenit 6 paragrafët (7) dhe (8)

#### Rregulli 6

(1) [Afatet lidhur me nenin 6 paragrafët (7) dhe (8)] Në përputhje me paragrafët (2) dhe (3), afatet nga neni 6 paragrafët (7) dhe (8) nuk guxojnë të jenë më të shkurtë se dy muaj nga data e njoftimit në përputhje me nenin 6 paragrafi (7).

(2) [Përfshirja nga afati lidhur me nenin 6 paragrafi (8)] Në përputhje me paragrafin (3), kur njoftimi sipas nenit 6 paragrafi (7) nuk është bërë për shkak të asaj se nuk janë

dorëzuar të dhënat për kontakt me aplikuesin, afati nga neni 6 paragrafi (8) nuk mund të jetë më i shkurtë se tre muaj nga data në të cilën një ose më shumë elementë nga neni 5 paragrafi (1)(a) janë pranuar për herë të parë nga Enti.

(3) *[Afatet sipas neni 6 paragrafët (7) dhe (8) për pagesën e taksave për aplikim në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave]* Kur taksat që duhet të paguhet në përputhje me nenin 6 paragrafi (4), në lidhje me dorëzimin e aplikacionit, nuk janë paguar, pala nënshkruese mund, në pajtim me nenin 6 paragrafët (7) dhe (8), të zbatojë afatet për pagesë, përfshirë edhe pagesën me vonesë, të cilat janë të njëjta me ato që zbatohen në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave në lidhje me taksat ndërkombëtare për aplikim.

Detaje në lidhje me përfaqësimin lidhur me nenin 7

### Rregulli 7

(1) *[Procedura të tjera lidhur me nenin 7 paragrafi (2)(a)(iii)]* Procedurat e tjera lidhur me neni 7 paragrafi (2)(a)(iii) për të cilët pala nënshkruese nuk mund të kërkojë përcaktim të përfaqësuesit janë:

- (i) dorëzimin e kopjes së aplikacionit të mëparshëm në përputhje me rregullin 2 paragrafi (4);
- (ii) dorëzimin e kopjes së aplikacionit të mëhershëm të dorëzuar sipas rregullit 2 paragrafi (5)(b).

(2) *[Përcaktimi i përfaqësuesit sipas neni 7 paragrafi (3)]*

(a) Pala nënshkruese pranon që emërimi (përcaktimi) i përfaqësuesit të dorëzohet deri tek Enti në:

- (i) formë të shkresës së veçantë (në tekstin e mëposhtëm “autorizim”), të nënshkruar nga ana e aplikuesit, bartësit apo personit tjetër të interesuar, në të cilin është potencuar emri dhe adresa e përfaqësuesit, ose, sipas zgjedhjes së aplikuesit,
- (ii) Formularë për kërkesë në pajtim me nenin 6 paragrafi (2), i nënshkruar nga aplikuesi.

(b) Një autorizim i vetëm është i mjaftueshëm madje edhe kur ka të bëjë me më shumë se një aplikim apo patentë të personit të njëjtë ose të një ose më shumë aplikacioneve dhe një ose më shumë patentave të të njëjtit person, me kusht që të gjitha aplikacionet dhe patentat të potencohen (listohen) në atë autorizim. Një autorizim i vetëm është i mjaftueshëm edhe kur ka të bëjë me të gjitha aplikacionet e dorëzuara dhe ato të ardhshme të atij personi, përveç për çfarëdo lloj përjashtimi të potencuar nga ana e personit të caktuar (emëruar). Enti, mund të kërkojë, kur ai autorizim i vetëm dorëzohet në formë të shkruar ose sido që të lejojë Enti, që kopje të veçantë të atij të dorëzohet për çdo aplikim ose patentë në veçanti.

(3) *[Përkthimi i autorizimit]* Pala nënshkruese mund të kërkojë, nëse autorizimi nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti, për të njëjtën të dorëzohet përkthim.

(4) *[Dëshmi]* Pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohet dëshmi deri tek Enti vetëm nëse enti ka dyshime të bazuara për vërtetësinë e ndonjë të dhëne që përmbahet në shkresën nga paragrafi (2)(a).

(5) [Afate në përputhje me nenin 7 paragrafët (5) dhe (6)] Në përputhje me paragrafin (6), afatet nga neni 7 paragrafi (5) dhe (6) nuk do të jenë më të shkurt[ se dy muaj nga data e njoftimit nga neni 7 paragrafi (5).

(6) [Përrjashtim nga afati nga neni 7 paragrafi (6)] Kur nuk është dorëzuar njoftimi nga neni 7(5) për të dhënat që mundësojnë që Enti të bie në kontakt me aplikuesin, bartësin apo personit tjetër të interesuar, afati nga neni 7 paragrafi (6) nuk duhet të jetë më i shkurtë se tre muaj nga data në të cilën ka filluar procedura nga neni 7 paragrafi (5).

## Dorëzimi i shkresave sipas neni 8 paragrafi (1)

### Rregulli 8

(1) [Shkresa e dorëzuar në formë të shkruar]

(a) Pas 2 qershor të vitit 2005 çdo palë nënshkruese mundet, në pajtim me nenin 5 paragrafë (1) dhe paragrafi (1)(e), të përjashtojë dorëzimin e shkresave në formë të shkruar ose mund të vazhdojë të lejojë dorëzimin e shkresave në formë të shkruar. Deri atëherë të gjitha palët nënshkruese lejojnë dorëzimin e shkresave në formë të shkruar.

(b) Në pajtim me nenin 8 paragrafi (3) dhe nënparagrafi (c), pala nënshkruese mund të përshkruaj kërkesa në lidhje me shkresat (fletëparaqitjet) në formë të shkruar.

(c) Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e shkresave në formë të shkruar, dhe Enti lejon që shkresat të dorëzohen në formë të shkruar, në pajtim me kushtet e Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave, që dorëzohen në formë të shkruar.

(d) Në të kundërtën e paragrafit (a), kur pranimi apo përpunimi i shkresës në formë të shkruar, për shkak të karakterit apo madhësisë së saj konsiderohet si jopraktik, pala nënshkruese mund të kërkojë që dorëzimi i shkresave të bëhet në formë tjetër ose me mjete të tjera të bartjes (transferit).

(2) [Shkresë (dokument) i dorëzuar në formë elektronike ose me mjete elektronike të bartjes]

(a) Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e shkresave në formë elektronike ose me mjete elektronike të bartjes deri tek Enti i saj në një gjuhë të caktuar, përfshirë e transferimin e letrave përmes telegrafit, teleprinterit, telefaksit apo mjeteve të ngjashme të transferim, dhe kur ekzistojnë kushte të cilat pala nënshkruese i zbaton në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave, në lidhje me dokumentet e dorëzuara në formë elektronike ose përmes mjeteve elektronike të transferit në atë gjuhë, Enti lejon dorëzimin e dokumenteve (shkresave) në formë elektronike ose me mjete elektronike të transferim në gjuhën e cekur në përputhje me këto kushte.

(b) Pala nënshkruese që lejon dorëzimin e dokumenteve në formë elektronike apo me mjete elektronike të transferit deri tek Enti, e njofton Byronë ndërkombëtare për kushtet nga ligji i saj që zbatohen në lidhje me këtë formë dorëzimi. Çdo njoftim shpallet nga ana e Byrosë ndërkombëtare në gjuhën në të cilën është përpiluar njoftimi dhe në gjuhët në të cilat janë përbërë tekstet autentike dhe zyrtare të Marrëveshjes në përputhje me nenin 25.

(c) Në raste kur, në pajtim me nënparagrafin (a), pala nënshkruese lejon dorëzimin e dokumenteve përmes telegrafit, teleprinterit, telefaksit apo mënyrave tjera të ngjashme të transferim, ajo mund të kërkojë që të dorëzohet deri tek Enti origjinali i cilitdo dokument që është bartur me këto mjete transferi, bashkë me një letër në të cilën thirret në atë transfero të mëparshëm, në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se një muaj nga data e transferimit.

(3) [Kopje, të dorëzuara në formë elektronike ose me mjete elektronike të bartjes, të dokumenteve të dorëzuar në formë të shkruar]

(a) Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e kopjeve në formë elektronike ose me mjete elektronike të bartjes (transferit) të dokumenteve të dorëzuar në formë të shkruar në gjuhë të pranuar nga Enti, dhe kur ekzistojnë kushte që zbatohen në atë palë nënshkruese në përputhje me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave në lidhje me dorëzimin e këtyre kopjeve të dokumenteve, Enti lejon dorëzimin e kopjeve të dokumenteve në formë elektronike ose përmes mjeteve elektronike të bartjes, në përputhje me ato kushte.

(b) Paragrafi (2)(b) aplikohet *mutatis mutandis* në kopjet e dorëzuara në formë elektronike ose përmes mjeteve elektronike të bartjes së dokumenteve, të dorëzuara në formë të shkruar.

Detaje në lidhje me nënshkrimin sipas nenit 8 paragrafi (4)

#### Rregulli 9

(1) [Tregues me nënshkrim] Pala nënshkruese mund të kërkojë që nënshkrimi i personit fizik që nënshkruan të shoqërohet me:

(i) tregimin (paraqitjen) e shkronjave të mbiemrit dhe një apo më shumë emrave të personit, ose sipas zgjedhjes së atij personi, të një emri apo më shumë emrave që ai person zakonisht i përdor;

(ii) potencimin (tregimin) e pozicionit të personit që nënshkruan, në raste kur nuk është e qartë nga teksti i dokumentit.

(2) [Data e nënshkrimit] Pala nënshkruese mund të kërkojë që nënshkrimi të shoqërohet me potencimin e datës kur është kryer nënshkrimi. Kur potencimi që kërkohet nuk është dorëzuar, data në të cilën nënshkrimi konsiderohet se është kryer do të jetë data në të cilën shkresa bashkë me nënshkrimin është pranuar nga Enti, ose, nëse pala nënshkruese lejon, datën para asaj date.

(3) [Nënshkrim i shkresave (dokumente) në formë të shkruar] Kur dokumenti para Entit së palës nënshkruese është në formë të shkruar dhe kërkohet nënshkrim, pala nënshkruese:

(i) në pajtim me pikën (iii), pranon nënshkrimin me dorë;

(ii) mund të lejojë, në vend të nënshkrimit me dorë, përdorimin e llojeve të tjera të nënshkrimit, siç është nënshkrimi i shtypur apo i stampuar, ose përdorimi i vulës apo afishes me kod;

(iii) kur personi fizik që nënshkruan dokumentin është shtetas i palës nënshkruese dhe adresa e atij personi është në territorin e saj ose kur personi juridik në emër të të cilit nënshkruhet dokumenti është i organizuar në pajtim me ligjin e saj dhe ka seli faktike të përhershme dhe efektive industriale dhe tregtare në territorin e saj, pala nënshkruese mund të kërkojë të përdoret vulë në vend të nënshkrimit me dorë.

(4) [Nënshkrimi i dokumentit i dorëzuar në formë elektronike ose me mjete elektronike të transferit] Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e dokumenteve në formë elektronike ose me mjete elektronike të transferim, dokumenti i tillë konsiderohet si i nënshkruar nëse paraqitja grafike e nënshkrimit të pranuar nga pala nënshkruese në përputhje me paragrafin (3) paraqitet në atë dokument ashtu siç është pranuar nga Enti i asaj pale nënshkruese.

(5) [Nënshkrimi i dokumenteve (shkresave) në formë elektronike që nuk është paraqitur (prezantuar) në formë grafike]

(a) Kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e dokumenteve në formë elektronike dhe prezantimi grafik i atij nënshkrimi të pranuar nga pala nënshkruese sipas paragrafit (3) nuk paraqitet në atë dokument siç është pranuar nga ana e Entit të asaj pale nënshkruese, nga pala nënshkruese mund të kërkojë që ai dokument të nënshkruhet me përdorimin e nënshkrimit në formë elektronike siç parasheh pala nënshkruese.

(b) Pa marrë parasysh nënparagrafin (a), kur pala nënshkruese lejon dorëzimin e dokumentit në formë elektronike në një gjuhë të caktuar dhe kur kushtet e zbatuara nga ajo palë nënshkruese janë në përputhje me Marëveshjen për bashkëpunim në fushën e patentave në lidhje me nënshkrimet në formë elektronike të dokumentave të dorëzuar në formë elektronike në atë gjuhë, e që nuk janë të paraqitura grafikisht, Enti i asaj pale nënshkruese pranon nënshkrim në formë elektronike në përputhje me këto kushte.

(c) Rregulli 8 paragrafi (2)(b) aplikohet *mutatis mutandis*.

(6) [Përjashtim të vërtetimit të nënshkrimit sipas nenit 8 paragrafi (4)(b)] Pala nënshkruese mund të kërkojë çdo nënshkrim në pajtim me paragrafin (5) të vërtetohet përmes procesit të vërtetimit të nënshkrimeve në formë elektronike, të përcaktuar nga pala nënshkruese.

Detaje në lidhje me të dhënat sipas nenit 8 paragrafët (5),(6) dhe (8)

## Rregulli 10

(1) [Të dhëna sipas nenit 8 paragrafi (5)]

(a) pala nënshkruese mund të kërkojë që në çdo shkresë (dokument):

- (i) të potencohet emri dhe adresa e aplikuesit, bartësit apo personit tjetër të interesuar;
- (ii) të potencohet numri i aplikacionit apo patentës për të cilën bëhet fjalë;
- (iii) të përmbajë, kur aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar është i regjistruar në Ent, numrin apo ndonjë të dhënë tjetër nën të cilën është regjistruar.

(b) pala nënshkruese mund të kërkojë çdo shkresë (dokument) nga ana e përfaqësuesit për qëllime të procedurës para Entit të përmbajë:

(i) emrin dhe adresën e përfaqësuesit;  
(ii) thirrje në autorizim, apo dokument tjetër në të cilin emërimi (autorizimi) i atij përfaqësuesi është ose ka qenë i kryer, në bazë të së cilës vepron përfaqësuesi;  
(iii) kur përfaqësuesi është i regjistruar në ent, numrin apo ndonjë të dhënë tjetër në bazë të të cilit është regjistruar.

(2) [*Adresa për korrespondencë dhe adresa për shërbime juridike*] Pala nënshkruese mund të kërkojë që adresa për korrespondencë sipas nenit 8 paragrafi (6)(i) dhe adresa për shërbime juridike sipas neni 8 paragrafi (6)(ii) të jenë në territorin që e përshkruan pala nënshkruese.

(3) [*Adresa kur nuk është caktuar përfaqësues*] Kur nuk është caktuar përfaqësues, ndërsa aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar ka siguruar, si adresë të tij, adresë në territorin e përshkruar nga pala nënshkruese sipas paragrafit (2), ajo palë nënshkruese e konsideron atë adresë si adresë korrespondence, në pajtim me neni 8 paragrafi (6)(i) apo adresë për shërbime juridike në pajtim me nenin 8 paragrafi (6)(ii), siç kërkon pala nënshkruese, përveç nëse aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar nuk potencon një adresë tjetër të tillë, në pajtim me nenin 8 paragrafi (6).

(4) [*Adresa kur është caktuar (emëruar) përfaqësues*] Kur është caktuar përfaqësues, pala nënshkruese e konsideron adresën e atij përfaqësuesi si adresë për korrespondencë sipas nenit 8 paragrafi (6)(i) ose adresë për shërbime juridike sipas nenit 8 paragrafi (6)(ii), siç kërkon pala nënshkruese, përveç nëse aplikuesi, bartësi apo personi tjetër i interesuar nuk potencon në mënyrë të qartë një adresë tjetër të tillë në pajtim me neni 8 (6).

(5) [*Sanksione për mosrespektimin e kushteve sipas nenit 8 paragrafi (8)*] Asnjë nga palët nënshkruese nuk guxon të parashohë refuzime të aplikacioneve nëse nuk plotësohen kushtet për dorëzimin e numrit të regjistrimit apo të dhëne tjetër sipas paragrafit (1)(a)(iii) dhe (b)(iii).

Afate në lidhje me shkresat sipas nenit 8 paragrafët (7) dhe (8)

#### Rregulli 11

(1) [*Afate sipas nenit 8 paragrafi 7 dhe 8*] Në pajtim me paragrafin (2), afatet nga neni 8 paragrafët (7) dhe (8) nuk duhet të jenë më të shkurtë se dy muaj nga data e njoftimit sipas nenit 8 paragrafi (7).

(2) [*Përjashtim nga afati sipas nenit 8 paragrafi (8)*] Kur njoftimi sipas nenit 8 paragrafi (7) nuk është kryer, meqenëse të dhënat që mundësojnë të kontaktohet ana e Entit aplikuesi, bartësi apo personit tjetër i interesuar nuk janë dorëzuar, afati sipas nenit 8 paragrafi (8) nuk do të jetë më i shkurtë se tre muaj nga data në të cilën shkresa sipas nenit 8 paragrafi (7) është pranuar nga ana e Entit.

Detaje për beneficione (përfitime) në lidhje me afatet sipas nenit 11

#### Rregulli 12

(1) [Kushte sipas nenit 11 paragrafi (1)]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa sipas nenit 11 paragrafi (1):

(i) të nënshkruhet nga aplikuesi apo bartësi;

(ii) të përmbajë shënim se kërkohet vazhdim i afatit dhe afati të jetë i përcaktuar.

(b) Kur kërkesa për vazhdimin e afatit është dorëzuar pas skadimit të afatit, pala nënshkruese mund të kërkojë njëkohësisht me dorëzimin e kërkesës të plotësohen të gjitha kushtet në drejtim të asaj që zbatohet në aspektin kohor dhe për cilat veprime.

(2) [Periudha dhe afati sipas nenit 11 paragrafi (1)]

(a) Periudha e vazhimit të afatit kohor sipas nenit 11 paragrafi (1) nuk do të jetë më i shkurtë se dy muaj nga data e skadimit të afatit të paskaduar.

(b) Afati sipas nenit 11 paragrafi (1)(ii) nuk mund të përfundojë më herët se dy muaj nga data e skadimit të afatit të paskaduar.

(3) [Kushte sipas nenit 11 paragrafi (2)(i)] Pala nënshkruese mund të kërkojë që kushti sipas nenit 11 paragrafi (2):

(i) të jetë i nënshkruar nga aplikuesi apo bartësi;

(ii) të përmbajë shënim se kërkohet vazhdim i afatit të humbur dhe potencim të afatit për të cilin bëhet fjalë.

(4) [Afati për dorëzimin e kërkesës sipas nenit 11 paragrafi (2)(ii)] Afati sipas nenit 11 paragrafi (2)(ii) nuk guxon të përfundojë më herët se dy muaj nga njoftimi i Entit se aplikuesi apo bartësi nuk kanë respektuar afatin që e ka përcaktuar Enti.

(5) [Përjashtime sipas nenit 11 paragrafi (3)]

(a) Sipas nenit 11 paragrafët (1) ose (2) nga asnjë palë nënshkruese nuk kërkohet të jap:

(i) vazhdim të dytë, apo çfarëdo vazhdimi të mëvonshëm të afatit për të cilin vetëm se është dhënë vazhdim sipas nenit 11 paragrafët (1) ose (2);

(ii) vazhdim të afatit për dorëzimin e kërkesës për vazhdim sipas nenit 11 paragrafët (1) ose (2) apo kërkesës për rivendosjen e të drejtave sipas nenit 12 paragrafi (1);

(iii) vazhdim në drejtim të afatit për pagesën e shpenzimeve për mirëmbajtje;

(iv) vazhdim në lidhje me afatin sipas nenit 13 paragrafët (1), (2) ose (3);

(v) vazhdim në lidhje me afatin për ndërmarrjen e veprimeve para këshillit për ankesa apo trupit tjetër revizues në kuadër të Entit;

(vi) vazhdimin në lidhje me afatin për veprim në procedurat *inter partes*.

(b) Nga asnjë palë nënshkruese që parasheh afat maksimal për plotësimin e kushteve për procedurë para Entit nuk kërkohet, sipas nenit 11 paragrafët (1) ose (2) të jap vazhdim në lidhje me afatet për veprime në atë procedurë në lidhje me cilindo nga ato kushte jashtë afatit maksimal.

Detaje në lidhje me rivendosjen e të drejtave pasi Enti do të evidentojë kujdes të duhur apo lëshim të paqëllimshëm sipas nenit 12

(1) [Kushte sipas nenit 12 paragrafi (1)(i)] Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa sipas nenit 12 paragrafi (1)(i) të jetë i nënshkruar nga ana e aplikuesit apo bartësit.

(2) [Afatit sipas nenit 12 paragrafi (1)(ii)] Afati për dorëzimin e kërkesës dhe për plotësimin e kushteve sipas nenit 12 paragrafi (1)(ii), është para skadimit të:

(i) jo më pak se dy muajve nga data e eliminimit të arsyes për shkak të mosrespektimit të afatit për veprim;

(ii) jo më pak se 12 muaj nga data e skadimit të afatit për veprim ose, kur kërkesa ka të bëjë me mospagesën e shpenzimeve për mirëmbajtje, jo më pak se 12 muaj nga data e skadimit të periudhës plotësuese të paraparë me nenin 5 *bis* të Konventës së Parisit.

(3) [Përjashtime sipas nenit 12 paragrafi (2)] Përjashtime sipas nenit 12 paragrafi (2) janë mosrespektim të afateve:

(i) për ndërmarrjen e veprimeve para këshillit për ankesa apo trupit tjetër revizor në kuadër të Enti;

(ii) për dorëzimin e kërkesës për vazhdim sipas nenit 11 paragrafët (1) ose (2) ose kërkesë për rivendosjen e të drejtave sipas nenit 12 paragrafi (1);

(iii) sipas nenit 13 paragrafët (1), (2) ose (3);

(iv) për ndërmarrjen e veprimeve në procedurat *inter partes*.

Detaje në lidhje me ndryshimin apo plotësimin e kërkesës për të drejtën e prioritetit dhe kthimit të së drejtës së prioritetit sipas nenit 13

#### Rregulli 14

(1) [Përjashtim sipas nenit 13 paragrafi (1)] Asnjë nga palët nënshkruese nuk është e obliguar të parashohë korrigjime ose plotësime të kërkesës për të drejtën e prioritetit sipas nenit 13 paragrafi (1), kur kërkesa sipas neni 13 paragrafi (1)(i) është marrë pasi aplikuesi ka dorëzuar kërkesë për shpallje të mëhershme ose për realizimin apo përsheptimin e procedurës, përveç nëse kërkesa për shpallje është mëhershme ose për realizim apo përsheptim të procedurës është tërheq para se të përfundojnë përgatitjet teknike për shpalljen e aplikacionit.

(2) [Kushte sipas nenit 13 paragrafi (1)(i)] Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa sipas nenit 13 paragrafi (1)(i) të jetë e nënshkruar nga ana e aplikuesit.

(3) [Afatit sipas nenit 13 paragrafi (1)(ii)] Afati sipas nenit 13 paragrafi (1)(ii) nuk duhet të jetë më i shkurtë se afati që zbatohet sipas Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave për aplikacion ndërkombëtar për dorëzimin e kërkesës për të drejtën e prioritetit pas dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar.

(4) [Afate sipas paragrafit 13 (2)]

(a) Afati sipas nenit 13 paragrafi (2), pjesa hyrëse, skadon për jo më pak se dy muaj nga data në të cilën skadon periudha e prioritetit.

(b) Afati sipas nenit 13 paragrafi (2)(ii) është afat që zbatohet në pajtim me nënparagrafin (a) ose afat kur përgatitjet teknike për shpalljen e aplikacionit të mëvonshëm kanë përfunduar, në varësi të asaj se cila skadon më herët.



(5) [Kushte sipas nenit 13 paragrafi (2)(i)] Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa sipas nenit 13 paragrafi (2)(i):

- (i) të jetë i nënshkruar nga aplikuesi; dhe
- (ii) të jetë e shoqëruar me kërkesë për prioritet, kur aplikuesi nuk kërkon të drejtën e prioritetit nga aplikacioni i mëparshëm.

(6) [Kushte sipas nenit 13 paragrafi (3)]

(a) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa sipas nenit 13 paragrafi (3)(i):

- (i) të jetë i nënshkruar nga ana e aplikuesit; dhe
- (ii) të përmbajë të dhënë për entin në të cilin është dorëzuar kërkesë për kopje (mostër) të aplikacionit të mëparshëm dhe datën e asaj kërkesë.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë:

- (i) deklarata apo dëshmia tjerët në shtesë të kërkesës sipas nenit 13 paragrafi (3) të dorëzohet në Ent në afat të cilin e përcakton ai Ent;
- (ii) kopje (mostra) nga aplikacioni i mëparshëm sipas nenit 13 paragrafi (3)(iv) të dorëzohet në Ent në afat që nuk do të jetë më i shkurtë se një muaj nga data në të cilën aplikuesi ka pranuar atë kopje nga Enti në të cilin është dorëzuar aplikacioni i mëparshëm.

(7) [Afati sipas nenit 13 paragrafi (3)(iii)] Afati sipas nenit 13 paragrafi (3)(iii) skadon dy muaj para skadimit të afatit të përcaktuar me rregullin 4 paragrafi (1).

Kërkesë për regjistrimin e ndryshimeve të emrit dhe adresës

## Rregulli 15

(1) [Kërkesa] Kur nuk ka ndryshime të aplikuesit apo bartësit, por ka ndryshime në emrin e tij apo adresën e tij, pala nënshkruese pranon që kërkesa për regjistrimin e ndryshimit të jetë me shkresë të nënshkruar nga aplikuesi apo bartësi dhe të përmbajë:

- (i) potencim (specifikim) se kërkohet regjistrim i ndryshimit të emrit apo adresës;
- (ii) numrin e aplikacionit apo patentës;
- (iii) ndryshimi që duhet të regjistrohet;
- (iv) emrin dhe adresën e aplikuesit apo bartësit para ndryshimit.

(2) [Taksa] Pala nënshkruese mund të kërkojë të paguhet taksa në lidhje me kërkesën nga paragrafi (1).

(3) [Kërkesë e vetme]

(a) Një kërkesë është e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë edhe me emrin edhe me adresën e aplikuesit ose bartësit.

(b) Një kërkesë është e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një aplikim ose patentë të të njëjtit person, ose të një ose më shumë aplikimeve dhe një ose më shumë patentave të të njëjtit person, me kusht ëq numrat e të gjitha aplikimeve dhe patentave për të cilat bëhet fjalë të potencohen (shënohen) në kërkesë. Pala

nënshkruese mund të kërkojë, kur një kërkesë dorëzohet në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër që lejon Enti, të dorëzohet kopje për çdo aplikacion në veçanti dhe për patentën për të cilin bëhet fjalë.

(4) [Dëshmi] Pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohet dëshmi para Entit vetëm kur Enti ka arsye të dyshojë në vërtetësinë e cilitdo informacion që përmbahet ë kërkesë.

(5) [Ndalesë për kushte të tjera] Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë që kushtet formale, përveç atyre nga paragrafët nga (1) deri (4), të plotësohen në drejtim të kërkesës nga paragrafi (1), përveç nëse është paraparë ndryshe në Marrëveshje ose është përshkruar në këtë rregullore. Në veçanti, nuk guxon të kërkohet dorëzimi i çfarëdo qoftë vërtetimi në lidhje me ndryshimin.

(6) [Njoftimi] Kur një ose më shumë kushte që i zbaton pala nënshkruese sipas paragrafëve nga (1) deri (4) nuk janë plotësuar, Enti njofton aplikuesin ose bartësin, duke i dhënë mundësi të plotësojë këto kushte dhe të deklarohet në afat jo më të shkurtë se dy muaj nga data e njoftimit.

(7) [Mosplotësimi i kushteve]

(a) Kur një ose më shumë kushte që i zbaton pala nënshkruese sipas paragrafëve nga (1) deri (4) nuk janë plotësuar në afatin nga nënparagrafi (b), pala nënshkruese mund të parashikojë refuzimin e kërkesës, por nuk mund të zbatojë masa më të rrepta.

(b) Afati sipas nënparagrafit (a) është:

- (i) në lidhje me pikën (ii), jo më pak se dy muaj nga data e njoftimit;
- (ii) kur nuk janë të dorëzuara të dhënat që mundësojnë të Enti të kontaktojë me personin që ka dorëzuar kërkesën nga paragrafi (1), jo më pak se tre muaj nga data në të cilën ajo kërkesë është pranuar në Ent.

(8) [Ndryshimi i emrit ose adresës së përfaqësuesit, ose adresës për korrespondencë apo adresës për shërbime juridike] Paragrafët nga (1) deri (7) zbatohen *mutatis mutandis* në çdo ndryshim në emrin apo adresën e përfaqësuesit dhe në çdo ndryshim të adresës për korrespondencë apo adresës për shërbime juridike.

Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit

## Rregulli 16

(1) [Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit]

(a) Kur ka ndryshim në aplikuesin ose bartësin, pala nënshkruese duhet të pranojë që kërkesa për regjistrimin e ndryshimit të jetë në shkresë (dokument) të nënshkruar nga ana e aplikuesit apo bartësit, ose nga ana e aplikuesit të ri apo bartësit të ri dhe të përmbajë të dhënat në vijim:

- (i) informacion në lidhje me atë se kërkohet regjistrim i ndryshimit të aplikuesit ose bartësit;
- (ii) numrin e aplikacionit ose patentës;
- (iii) emrin dhe adresën e aplikuesit ose bartësit;
- (iv) emrin dhe adresën e aplikuesit ose bartësit të ri;

- (v) datën e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit;
- (vi) emrin e shtetit, shtetas i të cilit është aplikuesi i ri ose bartësi i ri – nëse ai është shtetas i cilitdo shtet, emrin e shtetit në të cilin aplikuesi i ri ose bartësi i ri ka vendqëndrim – nëse ka të tillë, emri i shtetit në të cilin aplikuesi i ri ose bartësi i ri ka seli faktike dhe efektive industriale apo tregtare – nëse ekziston një e tillë;
- (vii) bazën për ndryshimin e kërkuar.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa të përmbajë:

- (i) deklaratë se informacionet që përmbahen në kërkesë janë të vërteta dhe të sakta;
- (ii) informacion për çdo lloj interesi shtetëror të palës nënshkruese.

(2) *[Dokumentacioni për bazën e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit]*

(a) Kur ndryshimi i aplikuesit ose bartësit rezulton nga marrëveshje, pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa të përmbajë të dhëna për regjistrimin e marrëveshjes, kur regjistrimi është i detyrueshëm në pajtim me ligjin që zbatohet dhe sipas zgjedhjes së palës që kërkon, drejt kërkesës në shtesë të dorëzohet si në vijim:

- (i) kopje e marrëveshjes se i njëjti përgjigjet me marrëveshjen origjinale, për të cilën mund të kërkohej të jetë e noterizuar nga notari apo ndonjë trup publik tjetër përgjegjës, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, ose kur është e lejuar me ligjin që zbatohet, nga përfaqësuesi i cili ka të drejtë të procedojë para Entit;
- (ii) ekstrakt nga marrëveshja që tregon ndryshimin, për të cilin mund të kërkohej të jetë i noterizuar nga notari ose ndonjë trup tjetër publik përgjegjës, sipas zgjedhjes së palës që kërkon ose, kur është e lejuar me ligjin që zbatohet, nga përfaqësuesi që ka të drejtë të procedojë para Entit, si ekstrakt nga marrëveshja origjinale;
- (iii) vërtetim të panoterizuar për bartjen e pronësisë me marrëveshje, me përmbajtje përkatëse me përmbajtjen e formularit ndërkombëtar në lidhje me vërtetimin e bartjes, të nënshkruar nga aplikuesi dhe aplikuesi i ri ose nga bartësi dhe bartësi i ri.

(b) Kur ndryshimi i aplikuesit ose bartësit rezulton nga bashkimi, ose nga riorganizimi ose ndarja e personit juridik, pala nënshkruese mund të kërkojë që bashkë me kërkesën të dorëzohet kopja e dokumentit që ka lëshuar trupi përgjegjës si dëshmi për bashkimin ose riorganizimin ose ndarjen e personit juridik dhe të drejtave që i takojnë, siç është kopje nga ekstrakti i regjistrimit tregtar. Pala nënshkruese mundet gjithashtu të kërkojë që kopja të jetë e noterizuar, se e njëjta përgjigjet me dokumentin origjinal, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, nga ana e trupit që ka lëshuar dokumentin ose nga notari ose ndonjë trup tjetër publik përgjegjës ose, kur është e lejuar me ligj që zbatohet, nga ana e përfaqësuesit që ka të drejtë të procedojë para Entit.

(c) Kur ndryshimi i aplikuesit ose bartësit nuk rezulton nga marrëveshje ose bashkim, apo riorganizim, ose ndarje të personit juridik, por bazohet në baza të tjera, për shembull, zbatim të ligjit apo vendim gjyqësor, pala nënshkruese mund të kërkojë që drejt kërkesës të bashkëngjiten kopja e dokumentit që evidenton atë ndryshim. Pala nënshkruese mund gjithashtu të kërkojë që kopja të jetë e vërtetuar se përgjigjet me dokumentin origjinal ose sipas zgjedhjes së palës që kërkon, nga ana e trupit të ka lëshuar atë dokument, nga notari apo trup tjetër përgjegjës ose, kur është e lejuar me ligj që zbatohet, nga përfaqësuesi që ka të drejtë të procedojë para Entit.

(d) Kur ndryshimi ka të bëjë me një ose më shumë persona, por jo edhe për secilin nga aplikuesit ose bartësit, pala nënshkruese mund të kërkojë që para Entit të dorëzohet

dëshmi për pajtueshmëri pas ndryshimit nga secili aplikuesi ose bartës për të cilët nuk ka ndryshim.

(3) [*Përktimi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë përktimin e çdo dokumenti të dorëzuar sipas paragrafit (2) që nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti.

(4) [*Shpenzime*] Pala nënshkruese mund të kërkojë pagesën e shpenzimeve në lidhje me kërkesën nga paragrafi (1).

(5) [*Kërkesë e vetme*] Vetëm një kërkesë është e mjaftueshme kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një aplikacion ose patentë të të njëjtit person ose një ose më shumë aplikacioneve dhe një ose më shumë patenta të të njëjtit person, me kusht që ndryshimi i aplikuesit ose bartësit të jetë i njëjtë për të gjitha aplikacionet ose patentat, si dhe të potencohen numrat e të gjitha aplikacioneve apo patentave në kërkesë. Pala nënshkruese mund të kërkojë, kur kërkesa e vetme është dorëzuar në formë të shkruar ose siç është e lejuar nga Enti, të dorëzohet kopje e veçantë për çdo aplikacion ose patentë për të cilën bëhet fjalë.

(6) [*Dëshmi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë që ajo dëshmi ose dëshmi tjetër në rastin nga paragrafi (2) të dorëzohet në Ent vetëm nëse ai Ent ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e ndonjë të dhëne që përmbahet në kërkesë ose në cilindo dokument nga ky rregull, ose në saktësinë e cilësdo dëshmi sipas paragrafi (3).

(7) [*Ndalesë për kushte të tjera*] Nga asnjë palë nënshkruese nuk duhet të kërkohet të plotësohen kushtet formale përveç atyre nga paragrafët nga (1) deri (6) në lidhje me kërkesën nga ky rregull, përve nëse është paraparë ndryshe me Marrëveshje ose nëse është përshkruar ndryshe në këtë rregullore.

(8) [*Njoftim; Mosplotësimi i kushteve*] Rreguli 15 paragrafët (6) dhe (7) zbatohen *mutatis mutandis* kur një ose më shumë kushte që zbatohen në pajtim me paragrafët (1) deri (5) nuk janë plotësuar ose kur kërkohet dëshmi apo dëshmi plotësuese sipas paragrafit (6).

(9) [*Përrjashtim që ka të bëjë me të drejtën e shpikësit*] Pala nënshkruese mund të përjashtojë zbatimin e këtij rregulli në lidhje me ndryshimet në të drejtën e shpikësit. E drejta e shpikësit përcaktohet sipas ligjit që zbatohet.

## Kërkesa për regjistrimin e licencës ose sigurimin e kërkesave

### Rregulli 17

(1) [*Kërkesa për regjistrimin e licencës*]

(a) Kur regjistrohet licenca në lidhje me aplikacionin ose patentën, sipas ligjit që zbatohet, pala nënshkruese pranon që ajo kërkesë për regjistrimin e licencës të dorëzohet me shkresë të nënshkruar nga ana e dhënësit të licencës ose marrësit të licencës dhe të përmbajë të dhënat në vijim:

- (i) potencim se kërkohet regjistrim i licencës;
- (ii) numrin e aplikacionit ose patentës;
- (iii) emrin ose adresën e dhënësit të licencës;
- (iv) emrin dhe adresën e marrësit të licencës;

(v) potencim për atë se a përfaqëson licenca, licencë ekskluzive apo licencë joekskluzive;

(vi) emrin e shtetit, shtetas i të cilit është marrësi i licencës – nëse është shtetas i cilitdo shtet, emrin e shtetit në të cilin marrësi i licencës ka vendqëndrim – nëse ka, emrin e shtetit në të cilin marrësi i licencës ka seli faktike dhe efektive industriale ose tregtare – nëse ekziston një e tillë;

(b) pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa të përmbajë:

(i) deklaratë se informacioni i përmbajtur në kërkesë është i vërtetë dhe i saktë;

(ii) informacion në lidhje me çfarëdo interesash shtetërore të asaj pale nënshkruese;

(iii) informacion në lidhje me regjistrimin e licencës, kur regjistrimi është i obligueshëm sipas ligjit që zbatohet;

(iv) data e licencës dhe kohëzgjatja e saj.

(2) [*Dokumentacioni mbi të cilin bazohet licenca*]

(a) Kur marrëveshja për licencë është e nënshkruar lirshëm, pala nënshkruese mund të kërkojë që bashkë me kërkesën të dorëzohet, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, një nga këto në vijim:

(i) kopje e marrëveshjes, për të cilën mund të kërkohej që të vërtetohet s'përgjigjet me marrëveshjen origjinale, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, nga noteri ose trupi thetër publik përgjegjës ose, kur është e lejuar me ligjin që zbatohet, nga ana e përfaqësuesit i cili ka të drejtë të procedojë para Entit,

(ii) ekstrakt nga marrëveshja për të cilin mund të vërtetohet se është ekstrakt i vërtetë nga marrëveshja, që përmban ato pjesë të marrëveshjes që tregojnë të drejtat e licencuara dhe përfshirjen e tyre, që mund të kërkohej të jetë i vërtetuar, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, nga noteri apo trup tjetër publik përgjegjës ose, kur është e lejuar me ligj, nga ana e përfaqësuesit që ka të drejtë të veprojë para Entit.

(b) pala nënshkruese mund të kërkojë, kur licenca është marrëveshje e nënshkruar lirshëm, çdo aplikuesi, bartës, marrës ekskluziv i licencës, çdo bashkë-pronar apo çdo marrës ekskluziv i licencës që nuk është pjesë e marrëveshjes, të jap pëlqim për regjistrimin e marrëveshjes në dokumentin e dorëzuar deri tek Enti.

(c) Kur licenca nuk është marrëveshje e nënshkruar lirshëm, për shembull, por është rezultat i vendimit ligjor ose gjyqësor, pala nënshkruese mund të kërkojë në shtesë të kërkesës të dorëzohet kopje e dokumentit që dëshmon licencën. Pala nënshkruese gjithashtu mund të kërkojë që kopja të jetë e vërtetuar se përgjigjet me dokumentin origjinal, sipas zgjedhjes së palës që kërkon, nga ana e trupit që lëshon dokumentin ose nga ana e notarit apo trupi tjetër publik përgjegjës ose, kur është e lejuar me ligj, nga ana e përfaqësuesit që ka të drejtë të procedojë para Entit.

(3) [*Përkthimi*] Pala nënshkruese mund të kërkojë përkthim për çdo dokument të dorëzuar sipas paragrafit (2) që nuk është në gjuhë të pranuar nga Enti.

(4) [*Shpenzime*] Pala nënshkruese mund të kërkojë të paguhen shpenzimet në lidhje me kërkesën sipas paragrafit (1).

(5) [*Kërkesë e vetme*] Rregulli 16 paragrafi (5) zbatohet *mutatis mutandis* në kërkesat për regjistrimin e licencës.

(6) [Dëshmi] Rregulli 16 paragrafi (6) zbatohet *mutatis mutandis* në kërkesat për regjistrimin e licencës.

(7) [Ndalesë për kushte të tjera] Nga asnjë palë nënshkruese nuk mund të kërkohej të plotësojë kushtet formale, përveç atyre nga paragrafët nga (1) deri (6) në lidhje me kërkesën nga paragrafi (1), përveç nëse është paraparë ndryshe me Marrëveshje ose përkrahur ndryshe në këtë rregullore.

(8) [Njoftim; Mosplotësimi i kërkesave] Rregulli 15 paragrafi (6) dhe paragrafi (7) zbatohen *mutatis mutandis* kur një ose më shumë kushte që zbatohen në pajtim me paragrafët nga (1) deri (5) nuk janë plotësuar ose kur dëshmi apo dëshmi plotësuese kërkohej në pajtim me paragrafin (6).

(9) [Kërkesë për regjistrimin e kërkesave ose tërheqjen e regjistrimit të licencës ose sigurimit të kërkesave] Paragrafët nga (1) deri (8) zbatohen *mutatis mutandis* në kërkesa për:

- (i) regjistrimin e sigurimit të kërkesave në lidhje me aplikacionin ose patentën;
- (ii) tërheqjen e regjistrimit të licencës ose të sigurimit të kërkesave në lidhje me aplikacionin ose patentën.

#### Kërkesë për korrigjim gabimi

#### Rregulli 18

(1) [Kërkesa]

(a) Kur aplikacioni, patenta ose ndonjë kërkesë tjetër që dorëzohet deri tek Enti në lidhje me aplikacionin ose patentën përmban gabim që nuk është i lidhur me hulumtimin ose ekzaminim thelbësor, që mund të korrigohej nga ana e Entit në bazë të ligjit, Enti pranon të dorëzohet deri tek Enti kërkesë e tillë për korrigjim të atij gabimi në regjistrat dhe shpalljet e Entit, me nënshkrim nga aplikuesi ose bartësi dhe të përmbajë elementët si në vijim:

- (i) potencim se kërkohej korrigjim i gabimit;
- (ii) numrin e aplikacionit ose kërkesës;
- (iii) gabimin që duhet të korrigohej;
- (iv) përmirësimi që duhet të kryhet;
- (v) emrin dhe adresën e palës që kërkon.

(b) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesës t'i bashkëngjitet pjesa për ndryshim ose pjesa që në vetvete përmban ndryshimin ose, kur aplikohet paragrafi (3), pjesë e tillë për ndryshim ose pjesë që në vetvete përfshin ndryshim për çdo aplikacion dhe patentë për të cilën bëhet fjalë në kërkesë.

(c) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa të jetë lëndë e deklaratës nga pala që kërkon, në të cilën do të shënohet se gabimi është bërë me qëllime të mira.

(d) Pala nënshkruese mund të kërkojë që kërkesa të jetë lëndë e deklaratës së palës që kërkon, në të cilën do të potencohet se kërkesa e cekur është dorëzuar pa vonesa të panevojshme, pas zbulimit të gabimit.

(2) [Taksa]

(a) Për procedim sipas paragrafit (b), pala nënshkruese mund të kërkojë që të paguhen shpenzime për kërkesën nga paragrafi (1).

(b) Enti i përmirëson gabimet e tij, sipas detyrës zyrtare ose në bazë të kërkesës, pa pagesë taksash.

(3) [Kërkesë e vetme] Rregulli 16 paragrafi (5) zbatohet *mutatis mutandis* në kërkesa për korrigjim të gabimit, me kusht që ai gabim dhe përmirësimi i kërkuar të jenë të njëjtë për të gjitha aplikacionet dhe patentat për të cilat bëhet fjalë.

(4) [Dëshmi] Pala nënshkruese mund të kërkojë që të dorëzohen deri tek Enti dëshmi në shtesë të kërkesës, vetëm nëse Enti ka dyshime të bazuara se bëhet fjalë për gabim, ose kur ka dyshime të bazuara në vërtetësinë e cilësdo çështje që përmbahet në kërkesë për korrigjim të gabimit ose në cilindo dokument të dorëzuar në lidhje me atë kërkesë.

(5) [Ndalesë për kushte të tjera] Nga asnjë palë nënshkruese nuk mund të kërkohet plotësimi i kushteve formale, përveç atyre nga paragrafët nga (1) deri (4) në lidhje me kërkesën nga paragrafi (1), përveç nëse është paraparë ndryshe me Marrëveshje ose nëse është përshkruar me këtë rregullore.

(6) [Njoftimi: Mosplotësimi i kushteve] Rregulli 15 paragrafi (6) dhe paragrafi (7) zbatohen *mutatis mutandis* kur një ose më shumë kushte që zbatohen sipas paragrafëve nga (1) deri (3) nuk janë plotësuar ose kur kërkohet dëshmi në pajtim me paragrafin (4).

(7) [Përjashtime]

(a) Pala nënshkruese mund të përjashtojë zbatimin e këtij rregulli në lidhje me ndryshime që kanë të bëjnë me të drejtën e shpikësit. Çfarë përfaqëson të drejtën e shpikësit do të përcaktohet me ligjin që zbatohet.

(b) Pala nënshkruese mund të përjashtojë zbatimin e këtij rregulli në lidhje me çdo gabim që duhet të përmirësohet në atë palë nënshkruese në përputhje me procedurën për dhënien sërish të patentës.

Mënyra e identifikimit të aplikacionit pa numrin e tij

#### Rregulli 19

(1) [Mënyra e identifikimit] Kur kërkohet që aplikacioni të identifikohet sipas numrit të tij, ndërsa ai numër ende nuk është lëshuar ose nuk është i njohur për personin që ka interes ose përfaqësuesin e tij, aplikacioni konsiderohet si e identifikuar nëse ai person sipas zgjedhjes së tij dorëzon diçka nga këto në vijim:

(i) numër të përkohshëm të aplikacionit, nëse ekziston, i dhënë nga Enti;

(ii) kopje të kërkesës që është pjesë e aplikacionit bashkë me datën në të cilën aplikacioni është dorëzuar në Ent;

(iii) numrin preferencial të aplikacionit të dhënë nga ana e aplikuesit ose përfaqësuesit të tij dhe të potencuar në aplikacion bashkë me emrin e tij dhe adresën e aplikuesit, emërtimin e shpikjes dhe datën në të cilën aplikacioni është dorëzuar në Ent.

(2) [Ndalese për kushte të tjera] Asnjë palë nënshkruese nuk guxon të kërkojë dorëzimin e mjeteve identifikuese përveç atyre nga paragrafi (1) me qëllim që aplikacioni të identifikohet nëse numri i tij ende nuk është lëshuar (caktuar) ose nuk është i njohur për personin që ka interes ose për përfaqësuesin e tij.

## Përcaktimi i llojeve të formularëve ndërkombëtar

### Rregulli 20

(1) [Lloje të formularëve ndërkombëtar] Kuvendi në pajtim me nenin 14 (1)(c), përcakton llojet e formularëve ndërkombëtar, në secilën prej gjuhëve sipas nenit 25(1), për:

- (i) autorizim;
- (ii) kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të emrit dhe adresës;
- (iii) kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të aplikuesit ose bartësit;
- (iv) vërtetimi për bartje;
- (v) kërkesë për regjistrimin ose tërheqjen e regjistrimit të licencës;
- (vi) kërkesë për regjistrimin ose tërheqjen e regjistrimit të sigurimit;
- (vii) kërkesë për korrigjimin e gabimit.

(2) [Ndryshime sipas Rregullit 3 paragrafi (2)(i)] Kuvendi në pajtim me rregullin 3 paragrafi (2)(i) përcakton ndryshimet në formularin për kërkesë sipas Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave.

(3) [Propozime të Byrosë Ndërkombëtare] Byroja ndërkombëtare dorëzon propozimet deri tek Kuvendi në lidhje me:

- (i) përcaktimin e llojeve të formularëve ndërkombëtar sipas paragrafit (1);
- (ii) ndryshimet e formularit sipas Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave, në përputhje me paragrafin (2).

## Kusht për unanimitet sipas nenit 14 paragrafi (3)

### Rregulli 21

Për përcaktimin ose ndryshimin e rregullave vijuese nevojitet unanimitet:

- (i) të çdo rregulli sipas nenit 5 paragrafi (1)(a);
- (ii) të çdo rregulli sipas nenit 6 paragrafi (1)(iii);
- (iii) të çdo rregulli sipas nenit 5 paragrafi (3);
- (iv) të çdo rregulli sipas nenit 7 paragrafi (2)(a)(iii);
- (v) rregullit 8 paragrafi (1)(a);
- (vi) të këtij rregulli.